



**UDHËZIME PËR ZBATIMIN E RLAH DHE FUP
PËR ROAMINGUN ME BALLKANIN PERËNDIMOR**

(Udhëzime për ofrimin e shërbimeve me pakicë roaming në Ballkanin Perëndimor për zbatimin e Vendimeve me nr.21-24/2019 dhe Rregullores së FUP të Këshillit Drejtues të AKEP)

(Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr.9, datë 9.06.2021)

PËRMBAJTJA

Hyrje 4

I. Objekti dhe fusha e veprimit.....	5
1. Shërbimet e rregulluara roaming.....	5
2. Objekti gjeografik i rregullimit të roaming.....	6
II. Heqja e tarifave shtesë për shërbimet me pakicë të roaming - RLAH.....	7
III. Tarifat me pakicë brenda vendit si bazë për tarifat me pakicë të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor.....	8
IV. Politika e Përdorimit të Drejtë.....	10
1. Vendbanimi i zakonshëm dhe lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë.....	10
2. Mekanizmi i kontrollit dhe treguesit objektivë	13
3. Rishitje e organizuar e kartave SIM.....	16
4. Politika e përdorimit të drejtë (FUP) në lidhje me paketat e hapura të të dhënave.....	16
i) Përkufizimi dhe përcaktimi i tarifës me pakicë brenda vendit i paketave të hapura të të dhënave	17
ii) Shembuj të paketave të hapura të të dhënave të ndryshme nga paketat me internet pa limit¹⁹	
iii) Përcaktimi i kufirit minimal të sasisë së të dhënave për paketat e hapura që mund të aplikohet në roaming BP	19
5. Tarifat me parapagim	24
V. Aplikimi i një tarife shtesë roaming (surcharge).....	27
1. Tarifa shtesë për konsum shtesë mbi kufirin e FUP ose për shkelje të FUP.....	27
2. Mungesë e provave të dokumentuar të vendbanimit të zakonshëm ose lidhjeje të qëndrueshme me Shqipërinë	29
3. Operatori celular ka prova thelbësore se ekziston rreziku i përdorimit abuziv ose anormal i shërbimeve roaming që nuk lidhen me udhëtim periodik në Ballkanin Perëndimor	29
4. Operatori celular ka prova thelbësore se një numër kartash SIM kanë qenë objekt i rishitjes së organizuar	29
5. Përdorimi aktual i të dhënave për roaming tejkalon kufirin e njërive minimale të të dhënave të paketës për roaming në Ballkanin Perëndimor me RLAH (pa tarifa shtesë roaming).....	30
6. Përdorimi aktual i të dhënave për roaming tejkalon kufirin e vëllimit të të dhënave në roaming që mund të blihet me kreditin e parapaguar të pajtimtarit.	31
VI. Tarifat alternative roaming.....	32
VII. Transferimi ndërmjet tarifave/planeve tarifore në roaming	33

VIII. Transparenca dhe mekanizmi i kontrollit	34
1. Informacion bazë i personalizuar tarifor për thirrjet, SMS dhe të dhëna	37
2. Njoftimi për konsumin brenda një FUP në lidhje me kufijtë sasiore të të dhënave	40
3. Paralajmërimi i pajtimtarit për aplikimin e një tarife shtesë të mundshme, bazuar në tregues objektivë.....	41
4. Kufiri financiar ose sasiore i konsumit të të dhënave roaming	42
IX. Intervalet e tarifimit.....	47
X. Tarifimi për mesazhet e postës zanore dhe SMS e marra	47
XI. Kursi i Këmbimit për konvertimin e tarifave shtesë roaming nga Euro në Lekë.....	47
XII. Roaming-u i padëshiruar.....	49
XIII. Planet tarifore pa shërbime roaming	50
XIV. Komunikimet makinë-makinë (M2M)	50
XV. Roli i AKEP në lidhje me FUP/zgjidhje mosmarrëveshje.....	51
XVI. Garantimi i qëndrueshmërisë së RLAH	53
1. Afatet.....	53
2. Kërkesat për të aplikuar për një përjashtim.....	53
3. Vlerësimi i aplikimit	56
4. Niveli dhe shpërndarja e tarifave shtesë roaming për të garantuar qëndrueshmërinë e RLAH	57
ANEKS 1.....	59

Hyrje

Këto udhëzime janë përgatitur nga AKEP për të shpjeguar zbatimin nga operatorët celularë të Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21-24, datë 24.6.2019, për rregullimin e tarifave të roamingut ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor, sipas “*Marrëveshje për reduktimin e çmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor*” (këtu e në vijim RRA WB6), si dhe të “*Rregullore mbi Zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së Heqjes së Tarifave Roaming me Pakicë (RLAH) me Ballkanin Perëndimor*”, miratuar me VKD nr.9, datë 9.06.2021.

Këto zëvendësojnë Udhëzimet e AKEP të nxjerra më datë 27.6.2019, të cilat shërbenin kryesisht për zbatimin e fazës tranzitore të roaming-ut RLAH+ më 1.7.2019-30.6.2021.

Bazuar në paragrafin e parë të nenit 6 të RRA WB6, këto udhëzime janë përgatitur, duke iu referuar dokumentit të BEREC, *BoR (17) 56 BEREC Guidelines on Regulation (EU) No. 531/2012 as amended by Regulation (EU) No. 2015/2120 and Commission Implementing Regulation (EU) 2016/2286 (Retail roaming Guidelines)*, duke i përshtatur në kontekstin e marrëveshjes rajonale të roaming-ut (RRA WB6).

I. Objekti dhe fusha e veprimit

1. Shërbimet e rregulluara roaming

1. Në përputhje me pikën 9 të pjesës arsyetuese të vendimeve të AKEP me nr. 22-24, datë 24.6.2019, shërbimet e rregulluara me pakicë roaming në Ballkanin Perëndimor, janë të përkufizuara si më poshtë:

- *“Thirrje roaming të rregulluara me pakicë”* përfshin thirrjet e kryera/marra nga pajtimtari i MNO (Operator Rrjeti Celular) i Republikës së Shqipërisë gjatë roaming-ut në operatorin e rrjetit të vizituar në Ballkanin Perëndimor, të cilat janë thirrje dalëse apo thirrje hyrëse drejt/nga Republika e Shqipërisë drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor.
- *“SMS roaming të rregulluara me pakicë”* përfshin SMS të dërguara/marra nga pajtimtari i MNO i Republikës së Shqipërisë gjatë roaming-ut në operatorin e rrjetit të vizituar në Ballkanin Perëndimor, të cilat janë SMS dalëse apo hyrëse drejt/nga Republika e Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.
- *“Shërbimi me pakicë i rregulluar i të dhënave në roaming”* përfshin shërbimin e roaming-ut që mundëson përdorimin e aksesit në Internet të pajtimtarit të MNO të Republikës së Shqipërisë gjatë roaming-ut në operatorin e rrjetit të vizituar në Ballkanin Perëndimor. Shërbimi i rregulluar i të dhënave nuk përfshin transmetimin apo marrjen e thirrjeve të rregulluara roaming apo SMS-ve, por përfshin transmetimin dhe marrjen e mesazheve MMS.

2. Thirrje të rregulluara roaming, përfshin thirrjet e kryera/marra nga pajtimtari i MNO i Republikës së Shqipërisë gjatë roaming-ut në operatorin e rrjetit vizitues në Ballkanin Perëndimor, të cilat janë thirrje dalëse drejt apo thirrje hyrëse nga Republika e Shqipërisë dhe/ose Ballkani Perëndimor, pjesë e marrëveshjes së roaming-ut. Këto thirrje përfshijnë p.sh., raste kur një pajtimtar celular i Republikës së Shqipërisë është në roaming në një vend të Ballkanit Perëndimor dhe kryen thirrje dalëse drejt Shqipërisë apo vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, si dhe thirrjet e marra (hyrëse) nga pajtimtari nga Shqipëria apo vendet e Ballkanit Perëndimor.

3. AKEP sqaron se, në këto thirrje nuk përfshihen p.sh., thirrjet e një pajtimtari të MNO të Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor kur pajtimtari ndodhet në Shqipëri, pasi në këtë rast pajtimtari nuk është në roaming, por po kryen një thirrje ndërkombëtare nga Shqipëria. Gjithashtu, në thirrjet e rregulluara roaming, nuk përfshihen thirrjet e pajtimtarit celular kur është në roaming në një vend të Ballkanit Perëndimor që kanë destinacion apo janë origjinuar nga një shtet tjetër i ndryshëm nga Ballkani Perëndimor. Pra, nëse pajtimtari celular ndodhet në roaming p.sh., në Kosovë apo një vend tjetër të Ballkanit Perëndimor dhe kryen/merr një thirrje drejt/nga Italia, apo një vend tjetër jashtë Ballkanit

Perëndimor, këto thirrje nuk konsiderohen thirrje të rregulluara roaming. Këto sqarime për thirrjet vlejné edhe për shërbimin e rregulluar të SMS-ve në roaming.

Thirrjet e rregulluara roaming përfshijnë vetëm thirrjet e origjinuara dhe terminuara në rrjetet celulare në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor. Përfshirja e thirrjeve drejt rrjeteve fikse në këtë periudhë pa rregulluar më parë tarifën e terminimit të këtyre thirrjeve ndërkombëtare, do të përbënte ofrim me humbje të këtyre thirrjeve për operatorët celularë. AKEP dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor do ta trajtojnë këtë çështje në një kohë të mëvonshme.

Shërbimi i rregulluar i të dhënave në roaming përfshin përdorimin e Internetit të pajtimtarit të MNO të Republikës së Shqipërisë në roaming në një rrjet MNO të vizituar në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, pavarësisht teknologjisë së përdorur 2G, 3G apo 4G etj. Si rregull, shërbimi i rregulluar roaming i të dhënave, nuk përfshin shërbime të ofruara përmes një lidhje Wi-Fi, përveç rasteve, kur lidhja Wi-Fi menaxhohet dhe/ose përdoret nga një operator rrjeti celular për të mundësuar ose rritur kapacitetin e disponueshëm të rrjetit dhe/ose mbulimit siç përcaktohet në dokumentet përkatëse të ETSI.

AKEP sqaron gjithashtu se objekt i rregullimit të tarifave roaming në Ballkanin Perëndimor janë vetëm shërbimet celulare të kryera/marra nëpërmjet rrjeteve të lëvizshme tokësore në Republikën e Shqipërisë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, dhe nuk përfshijnë thirrjet apo komunikime të tjera të kryera apo marra drejt/nga anijet ose avionë që përdorin rrjete satelitore.

- 4.** Sipas përkufizimit në pikën 2/h, të nenit 2, të Rregullores së FUP, "klient roaming" do të thotë një pajtimtar i një operatori celular në Republikën e Shqipërisë, (me paspagim apo parapagim) i cili në bazë të kontratës që ka me operatorin celular përdor shërbimet e rregulluara roaming me pakicë të ofruara nga ky operator, kur pajtimtari ndodhet në një prej vendeve të Ballkanit Perëndimor.

2. Objekti gjeografik i rregullimit të roaming

- 5.** Objekti i vendimeve të AKEP me nr. 22-24, datë 24.6.2019, si dhe Rregullore e AKEP për FUP, janë shërbimet e roaming-ut me shumicë/pakicë të ofruara nga operatorët celularë të Republikës së Shqipërisë për operatorët e tjerë celularë të Ballkanit Perëndimor/pajtimtarët e tyre kur janë në roaming në Shqipëri/Ballkanin Perëndimor. Pra, detyrimet e operatorëve celularë për shërbimet e rregulluara roaming me pakicë, të përcaktuara në aktet e cituara të AKEP, janë të aplikueshme kur pajtimtarët celularë të Republikës së Shqipërisë janë në

roaming në rajonin e Ballkanit Perëndimor, që përfshin Bosnje dhe Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.

- 6.** Pavarësisht sa më sipër, një pjesë e detyrimeve të operatorëve celularë të përcaktuara në pikën (nenin) 6 të vendimeve të AKEP, me nr. 22-24, datë 24.6.2019, që lidhen me vënien në dispozicion të pajtimtarëve e të paktën një kufiri financiar të parazgjedhur/default (që duhet të jetë jo më i madh se 5000 (pesë mijë) LEKË (outstanding charges) për çdo periudhë faturimi mujor (pa TVSH), janë të aplikueshme dhe kur pajtimtari është në roaming në vende të tjera, përveç Ballkanit Perëndimor. Për më shumë, në lidhje me kufirin financiar mund të shikoni Seksionin VIII/4 të këtij Udhëzimi.

II. Heqja e tarifave shtesë për shërbimet me pakicë të roaming - RLAH

- 7.** Në bazë të marrëveshjes rajonale të roaming-ut, si dhe vendimeve të AKEP me nr. 22-24, datë 24.6.2019 (pika 4/1 dhe 4/5), duke filluar nga data 1 korrik 2021, operatorët celularë kanë detyrim që të mos tarifojnë asnjë tarifë shtesë (surcharge) roaming për shërbimet e roaming-ut të ofruara pajtimtarëve të tyre kur këta të fundit vizitojnë vendet e Ballkanit Perëndimor, përveç tarifës/tarifave përkatëse me pakicë të aplikueshme për pajtimtarin brenda vendit, pra sipas modelit RLAH, apo roaming me tarifa sikur të jesh brenda vendit.
- 8.** Në periudhën 1.7.2019 - 30.6.2020, operatorët celularë kanë të drejtë që për shërbimet e rregulluara të roaming-ut me pakicë në Ballkanin Perëndimor të aplikojnë një tarifë shtesë (surcharge) mbi tarifën përkatëse të pajtimtarit të aplikuar kur ai ndodhet në Shqipëri, ndërsa duke filluar nga data 1.7.2021 hyn në fuqi heqja e këtyre tarifave shtesë të roaming-ut me pakicë në Ballkanin Perëndimor. Pra, për pajtimtarët celularë të Shqipërisë, kur ata vizitojnë dhe përdorin shërbimet roaming në vendet e Ballkanit Perëndimor, do të aplikohen të njëjtat kushte tarifore sikur të jenë në Shqipëri, të cilat mund të jenë objekt i kushteve të përcaktuara në Politikën e Përdorimit të Drejtë (FUP), sipas rregullores përkatëse të AKEP. Zbatimi i RLAH u mundëson pajtimtarëve celularë të përdorin paketën tarifore brenda vendit (në Shqipëri) edhe kur janë në roaming në Ballkanin Perëndimor.
- 9.** Operatorët celularë nuk lejohen të aplikojnë tarifë ekstra jo vetëm për shërbimet, por as ndonjë tarifë të përgjithshme për të mundësuar përdorimin e shërbimeve roaming sipas regjimit RLAH. Kjo do të thotë që operatorët celularë, si ofrues të roaming-ut, nuk mund të aplikojnë një tarifë shtesë direkte ose indirekte për të mundësuar roaming në Ballkanin Perëndimor. Një shembull i një tarife shtesë indirekte për të mundësuar roaming do të ishte nëse dy plane tarifore identike të një operatori celular ndryshojnë vetëm në tarifën fikse periodike dhe aftësinë për të përdorur roaming: planet tarifore A dhe B të një operatori kanë të njëjtat shërbime të përfshira në tarifatat fikse periodike (p.sh., mujore apo tjetër periudhë fikse), por plani A që përfshin dhe mundësinë e roaming-ut në Ballkanin Perëndimor kushton më shumë se plani B që ka të përjashtuar mundësinë e roaming-ut. Pra, ky rast i aplikimit të tarifave të ndryshme për të njëjtin plan tarifor, me apo pa mundësi roaming-u, nuk është i lejuar. Tjetër shembull që nuk

lejohe të aplikimi nga operatori celular i Republikës së Shqipërisë i një tarife shtesë për pajtimtarët që janë në Shqipëri kur këta bëjnë thirrje drejt një pajtimtari që ndodhet në roaming. Së fundmi, sqarohet se pajtimtarët që përdorin tarifa/plane tarife që nuk përfshijnë përdorim të shërbimeve roaming, pra që nuk e kanë roaming-un të aktivizuar, nuk do kenë të drejtë të përfitojnë shërbime roaming sipas tarifave brenda vendit.

10. Sipas nenit 4/6, të vendimeve të AKEP, me nr. 22-24, datë 24.6.2019, operatorët celularë kanë të drejtë që të aplikojnë një limit sasior për përdorim të drejtë të shërbimeve të rregulluara roaming të ofruara me RLAH, me qëllim që të parandalojnë përdorimin abuziv ose jonormal të shërbimeve të roaming-ut me pakicë nga pajtimtarët gjatë roaming-ut në vendet e Ballkanit Perëndimor për qëllime të ndryshme nga udhëtimi periodik në këto vende. Rregullat për aplikimin e politikave të tilla të përdorimit të drejtë të shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë në Ballkanin Perëndimor, janë të përcaktuara në Rregulloren e AKEP për *“Zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së Heqjes së Tarifave Roaming me Pakicë (RLAH) me Ballkanin Perëndimor”*, miratuar me vendim nr. __, datë __. __. 2021.

11. Në rastet kur pajtimtarët tejkalojnë limitin e përcaktuar nga operatori celular sipas FUP, operatori celular ka të drejtë të kërkojë nga pajtimtari të paguajë një tarifë ekstra (surcharge) për sasinë e konsumuar mbi limitin e përcaktuar të shërbimeve të rregulluara roaming. Megjithatë, sipas nenit 4/8, të vendimeve të AKEP, me nr. 22-24, datë 24.6.2019, tarifa shtesë (surcharge) që mund të aplikojë operatori në të tilla raste duhet të jetë brenda tavaneve të përcaktuara sipas këtyre vendimeve të AKEP.

III. Tarifat me pakicë brenda vendit si bazë për tarifat me pakicë të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor.

12. Objektivi kryesor i Marrëveshjes Rajonale të Roaming-ut (RRA) si dhe vendimeve të AKEP me nr. 22-24, datë 24.6.2019, është heqja e tarifave shtesë për shërbimet me pakicë të roaming-ut. Në këtë mënyrë, rregulli i përgjithshëm është që baza për tarifat shërbime të rregulluara roaming me pakicë në Ballkanin Perëndimor do të jenë tarifat me pakicë që operatorët celularë aplikojnë për pajtimtarin brenda vendit. Ndërsa në periudhën 1.7.2019 - 30.6.2021 operatori celular për shërbimet e rregulluara roaming me pakicë në Ballkanin Perëndimor mund të aplikojë një tarifë shtesë mbi tarifën brenda vendit (RLAH+), duke filluar nga 1.7.2021 operatorët celularë nuk mund të aplikojnë më tarifë shtesë për shërbimet e rregulluara roming në Ballkanin Perëndimor mbi tarifën përkatëse që aplikohet brenda vendit. Ky model tarifimi njihet si RLAH (Roam Like At Home), apo Roaming si në Shtëpi.

13. Në rastin e tarifave për njësi (për minutë, SMS apo MG/GB) të shitjes me pakicë të shërbimeve celulare brenda vendit, operatorët kanë të drejtë të aplikojnë tarifa të ndryshme brenda rrjetit ("on-net") dhe drejt rrjeteve të tjera celulare ("off-net"), ku tarifat off-net zakonisht janë më të larta se ato on-net. Ndërkohë, bazuar në Vendimet e AKEP, prej datës 1 korrik 2015, operatorët

celularë në Shqipëri kanë detyrim që të mos aplikojnë tarifa më të larta për thirrjet off-net se për thirrjet on-net. Për qëllime të zbatimit të përkufizimit të nenit 3, pika 2/i, të Rregullores së FUP, operatorët celularë mund (kanë të drejtë) të përdorin tarifat e SMS-ve off-net si bazë (tarifa brenda vendit) për tarifat roaming RLAH për SMS, dhe tarifat e thirrjeve kombëtare apo off-net si bazë për tarifat roaming RLAH për thirrjet. Në rast se operatori aplikon çmime të ndryshme off-net drejt rrjeteve të ndryshme në të njëjtën paketë tarifore, operatorët do të duhet të aplikojnë në roaming në Ballkanin Perëndimor të njëjtin mekanizëm tarifimi i cili do të zbatohet për klientët përkatës roaming sikur ata të ishin në Shqipëri.

14. Në rastet kur nuk mund të përcaktohet një tarifë specifike me pakicë për njësi për shërbimet e konsumuara brenda vendit, p.sh., për planet apo paketat (bundles) tarifore që përfshijnë në tarifën fikse periodike sasi pa limit të një shërbimi apo disa shërbimeve, operatorët duhet të aplikojnë në roaming në Ballkanin Perëndimor të njëjtin mekanizëm tarifimi me atë të aplikuar kur pajtimtari konsumon shërbimet e planit tarifor në Shqipëri. Për paketat tarifore që përfshijnë sasi të caktuar shërbimi në tarifën fikse periodike (bundles), operatorët duhet të aplikojnë në roaming në Ballkanin Perëndimor të njëjtin mekanizëm tarifimi si në Shqipëri, pra çdo sasi e konsumuar në roaming (thirrje zanore, SMS ose të dhëna) duhet të zbritet nga njësitë e përfshira në paketë (në rast të thirrjeve zanore dhe SMS, ato mund të zbriten nga sasi të përkatëse off-net nëse ka të tilla dhe sipas sqarimeve për detyrimet për mosdiskriminim të thirrjeve on dhe off-net).

15. Në disa plane tarifore, thirrjet apo SMS-të drejt grupeve të kufizuara (për shembull anëtarët e familjes, një grup miqsh ose kolegë pune) mund të tarifohen me tarifa preferenciale. Në këtë rast, operatorët nuk duhet të tarifojnë më shumë sesa traifa përkatëse off-net e zbatueshëm për thirrjet/SMS-të në atë grup (duke respektuar dhe FUP, nëse aplikohet). Në rastet kur këto plane tarifore kanë sasi të caktuara shërbimesh të përfshira në shportë (bundle), operatorët mund të zbresin, si maksimum, sasi të off-net nga këto njësi të përfshira në paketë. Në planet tarifore të zbatueshme për një grup përdoruesish, ku njësitë e përfshira të të dhënave mund të ndahen midis një numri përdoruesish, zbatohen të njëjtat rregulla, që do të thotë se njësitë e përfshira të të dhënave mund të ndahen (përdoren) nga të gjithë përdoruesit gjatë roaming-ut në Ballkanin Perëndimor.

16. Nëse operatorët aplikojnë një tarifë fikse apo kohë minimale tarifimi (set-up fee) për thirrjet brenda vendit, ata gjithashtu mund ta bëjnë këtë për pjesën e tarifës brenda vendit për thirrjet në roaming, por jo për tarifën shtesë roaming (për më shumë shiko Kapitullin X).

IV. Politika e Përdorimit të Drejtë

17. Sipas nenit 4/6, të vendimeve të AKEP nr. 22-24, datë 24.6.2019, qëllimi i FUP është që të mundësojë operatorët celularë të parandalojnë përdorimin abuziv ose anormal, siç është përdorimi i shërbimeve roaming për qëllime të ndryshme nga ato të udhëtimit periodik në vendet e Ballkanit Perëndimor.

18. Parimi bazë i FUP është që një MNO t'u ofrojë klientëve/pajtimtarëve të tij, të cilët janë vendbanues të zakonshëm në Shqipëri, ose kanë lidhje të qëndrueshme që sjellin një prani të shpeshtë dhe thelbësore në Shqipëri, ndërsa ata udhëtojnë në vendet e Ballkanit Perëndimor, shërbime të rregulluara roaming me pakicë në nivelin e tarifave përkatëse brenda vendit (në Shqipëri), në të njëjtat kushte sikur këto shërbime të konsumoheshin në Shqipëri.

19. Përveç kërkesave të vendbanimit të zakonshëm ose lidhjeve të qëndrueshme, FUP përfshin elementë të tjerë si mekanizmi i kontrollit, i bazuar në tregues objektivë, masa për të ndaluar rishitjen e organizuar të kartave SIM, si dhe limitet sasiore për paketat e hapura të të dhënave dhe planet tarifore me parapagim. Zbatimi i një ose më shumë prej këtyre koncepteve/instrumenteve nga operatori konsiderohet si zbatim i FUP.

1. Vendbanimi i zakonshëm dhe lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë

20. Neni 3 i Rregullores së FUP përcakton detyrimin që operatori celular ka që të ofrojë tarifa roaming RLAH për pajtimtarët e tij, të cilët janë me "**vendbanim të zakonshëm**" në Shqipëri ose kanë "**lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë, duke sjellë një prani të shpeshtë dhe të konsiderueshme të tyre në Shqipëri**". Pika 2/a, e nenit 2, të Rregullores së FUP, përcakton termin "lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë" dhe përfshin situatat e pranisë së pajtimtarit në Shqipëri, duke përshkruar situatat e listuara më poshtë (që përbën një listë jo-shteruese):

- marrëdhënie punësimi me kohë të plotë dhe të qëndrueshme (afatgjatë), përfshirë atë të punonjësve ndërkufitarë; 1
- marrëdhënie kontraktuale afatgjata, që sjellin një shkallë të ngjashme të pranisë fizike të një personi të vetëpunësuar;
- pjesëmarrje në kurse periodike studimi me kohë të plotë; ose
- situata të tjera, të tilla si ato të punëtorëve sezonalë ose ato të personave në pension, sa herë që përfshijnë një nivel të ngjashëm të pranisë territoriale.

Ligji nr.120/2020 "Për censin e popullsisë dhe banesave" në nenin 3 (germa ç) përmban përkufizimin e mëposhtëm për vendbanimin e zakonshëm:

¹ Një punonjës që është i punësuar në një vend të Ballkanit Perëndimor, kufitar me Shqipërinë, por që kthehet çdo ditë ose të paktën një herë në javë në Shqipëri. (*In the EU context, a worker who is employed in the frontier zone of an EU Member State but who returns each day or at least once a week to the frontier zone of a neighbouring country in which they reside and of which they are nationals.*)

“Vendbanim i zakonshëm” është vendi ku personi zakonisht kalon periudhën e përditshme të pushimit, pavarësisht nga mungesa të përkohshme për qëllime rekreative, pushime, vizita në miq dhe të afërm, biznes, trajtim mjekësor ose pelegrinazhi fetar.

Personat, që konsiderohen si vendbanues të zakonshëm të një zone gjeografike, janë ata:
i. që kanë jetuar në vendbanimin e tyre të zakonshëm për një periudhë të vazhdueshme, të paktën 12 muaj përpara ditës së censit; ose

ii. që kanë ardhur në vendbanimin e tyre të zakonshëm gjatë 12 muajve para ditës së censit, me qëllim që të qëndrojnë aty të paktën për një vit.

Kur rrethanat e përshkruara në paragrafët “i” ose “ii” nuk mund të përcaktohen, “vendbanim i zakonshëm” do të thotë vendi i ligjshëm ose vendbanimi i regjistruar

INSTAT jep shpjegimet e mëposhtme në lidhje me këtë term të përdorur për regjistrimin e popullsisë:

Baza e popullsisë që do të përdoret për qëllime të krahasimeve ndërkombëtare është 'popullsia me vendbanim të zakonshëm'. 'Popullsia me vendbanim të zakonshëm' e një vendi përbëhet nga ata persona që kanë vendbanimin e tyre të zakonshëm në vend në kohën e referimit të regjistrimit dhe kanë jetuar ose kanë ndërmend të jetojnë atje për një periudhë të vazhdueshme kohore prej së paku 12 muajsh. Një 'periudhë e vazhdueshme kohore' do të thotë se mungesat (nga vendi i vendbanimit të zakonshëm), kohëzgjatja e të cilave është më e shkurtër se 12 muaj nuk ndikojnë në vendin e banimit të zakonshëm.

AKEP sqaron se përkufizimet e mësipërme për vendbanimin e zakonshëm në Shqipëri, nuk nënkuptojnë që MNO të kërkojnë prova nga pajtimtarët që të përmbushin të gjitha kriteret e mësipërme. MNO-të duhet të respektojnë përcaktimet e Rregullores së FUP si dhe të sqarimet e dhëna më poshtë për këtë çështje.

21. Për të siguruar që shërbimet e roaming-ut me pakicë nuk bëhen objekt i përdorimit abuziv ose anormal, të palidhura me udhëtimet normale periodike të pajtimtarëve të tyre, operatorët mund të kenë nevojë të përcaktojnë vendbanimin e zakonshëm të pajtimtarëve të tyre në Shqipëri që përdorin shërbimet roaming në Ballkanin Perëndimor sipas RLAH, ose ekzistencën e lidhjeve të qëndrueshme të tyre me Shqipërinë. Për këtë qëllim, operatori celular duhet të jetë në gjendje të specifikojë dokumente të arsyeshme që vërtetojnë vendbanimin e pajtimtarit në Shqipëri ose lidhjet e qëndrueshme të tij me Shqipërisë, dhe këto kërkesa duhet të jenë transparente për pajtimtarët e operatorit dhe objekt i mbikëqyrjes së AKEP, për sa i përket proporcionalitetit të barrës së përgjithshme dokumentare të kërkuar dhe përshtatshmërinë e tyre në kontekstin kombëtar, pra në Shqipëri.

22. Në paragrafët më poshtë, AKEP ka dhënë një listë jo-shteruese të dokumenteve që mund të kërkojë operatori për të përcaktuar vendbanimin e zakonshëm ose lidhjet e qëndrueshme të pajtimtarit me Shqipërinë. AKEP sqaron se, megjithëse operatori celular ka të drejtë të kërkojë një dokumentacion të tillë, çdo kërkesë për prova të tilla duhet të jetë e arsyeshme dhe nuk është e detyrueshme për operatorët celularë. Gjithashtu, kërkesa e provës dokumentare nga

operatori duhet të ketë parasysh dokumentet e zakonshme të përdorura në Shqipëri si dhe nivelin e perceptuar të rrezikut të përdorimit abuziv ose anormal të shërbimeve nga pajtimtari.

23. AKEP sqaron se MNO-të duhet t'u japin të gjithë klientëve të tyre një listë jo-shteruese të llojeve të dokumenteve të mundshëm vërtetues për vendbanimin dhe lidhjet e qëndrueshme, dhe ta publikojnë paraprakisht këtë listë në faqen e internetit të tyre, si dhe ta kenë të disponueshme atë në pikat e shitjes së tyre, për të mundësuar klientët/pajtimtarët e tyre që të zgjedhin llojet e dokumenteve që mund të japin nëse është e nevojshme. AKEP vlerëson gjithashtu se këta klientë mund të ftohen të zgjedhin nga lista e sugjeruar çdonjë prej kategorive të aplikueshme për lidhjet e qëndrueshme. Në këtë aspekt, AKEP vlerëson si të arsyeshme dhe proporcionale që çdo provë e besueshme lehtësisht e arritshme që tregon lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë (që ndryshon nga vendbanimi i zakonshëm apo i përhershëm) dhe që është e pranueshme nga MNO në fazën e lidhjes së kontratës, të jetë e pranueshme dhe për qëllime të aplikimit të Rregullores së FUP.

24. AKEP vlerëson se secili nga elementët e mëposhtëm mund të konsiderohet si dokument vërtetues për vendbanimin e zakonshëm në Shqipëri ose lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë në funksion të zbatimit të Rregullores së FUP dhe parimeve të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit:

- vërtetim/provë regjistrimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- faturë e shërbimeve të tilla si energji elektrike, ujë, shërbime telefonike/interneti nga rrjet fiks etj., ku tregohet qartë emri/mbiemri i pajtimtarit dhe detaje të adresës së banimit/përfitimit të shërbimit përkatës të cituar;
- dokument i vlefshëm që dëshmon se personi bën pjesë në një nga kategoritë e lidhjeve të qëndrueshme me Shqipërinë;
- një deklaratë ose dokument tjetër vërtetues, i lëshuar nga punëdhënësi ose institucion arsimor;
- provë regjistrimi në regjistra të organeve të pushtetit lokal si bashki apo institucione të tjera publike;
- prova shtesë punësimi (në rastin e punëtorëve ndërkufitar) nga një kompani në një vend të ndryshëm nga ai i vendbanimit të përhershëm;
- çdo provë tjetër e arsyeshme që mund të përdoret për të provuar lidhje të qëndrueshme ose vendbanim të zakonshëm në Shqipëri, p.sh., Kontratë qiraje për shtëpi;
- në rastin e klientëve/pajtimtarëve të kategorisë biznes, dokumentet vërtetues mund të përfshijnë regjistrimin në QKB, aktin e themelimit në Gjykatë, vendndodhjen kryesore të kryerjes së aktivitetit, ose vendin kryesor ku punojnë të punësuarit të identifikuar/regjistruar si pajtimtarë/përdorues të kartave SIM përkatëse etj.

Në dokumentet e kërkuar, AKEP rekomandon pranimin nga MNO-të të dokumenteve përkatës elektronikë që mund të merren nga qytetarë/biznese shqiptare dhe qytetarë të huaj nëpërmjet portalit e-albania.

25.Neni 4 (1), i Rregullores së FUP i jep të drejtë operatorit që të kërkojë nga pajtimtari prova të vendbanimit të zakonshëm ose të lidhjeve të tjera të qëndrueshme me Shqipërinë përpara se t'i ofrojë pajtimtarit shërbime të rregulluara të roaming-ut me pakicë me çmimin e aplikueshëm në Shqipëri. Dokumente të tillë mund të kërkojnë para ose pas përfundimit të një kontrate. Në lidhje me pajtimtarët ekzistues përpara datës 1 korrik 2021, AKEP sqaron se çdo informacion të besueshëm në lidhje me këta pajtimtarë që disponohet tashmë prej operatorit, duhet të përdoret nga operatori si provë e lidhjeve të qëndrueshme ose vendbanimit të zakonshëm dhe këta pajtimtarë duhet të kalojnë automatikisht në skemën tarifore RLAH kur vizitojnë vendet e Ballkanit Perëndimor pas datës 1.7.2021. Për kontratat e lidhura pas datës 1 korrik 2021, çdo kërkesë e operatorit ndaj pajtimtarit për dhënie të provave të vendbanimit të zakonshëm ose lidhjeve të qëndrueshme me Shqipërinë, duhet të kufizohet në mënyrë rigoroze në rastet kur të dhënat që mblidhen për qëllime faturimi rezultojnë se japin indikacione të përdorimit abuziv ose anormal, të palidhur me udhëtime periodike në Ballkanin Perëndimor. Nëse një kërkesë e tillë bëhet nga operatori pas datës 1 korrik 2021, në kohën e lidhjes së një kontrate ose pas një njoftimi paralajmërues sipas nenit 5 (3), të Rregullores së FUP, dhe pajtimtari nuk mund të ofrojë dokumentacion që të vërtetojë vendbanimin e përhershëm ose lidhjet e qëndrueshme me Shqipërinë, operatori nuk ka detyrim të ofrojë tarifim RLAH për atë klient/pajtimtar, por përkundrazi, do të ketë të drejtë të aplikojë tarifa shtesë (surcharges) për çdo përdorim të mëtejshëm të shërbimeve të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor. Informacioni në lidhje me tarifën shtesë të aplikueshme është përfshirë në kapitullin V të këtij dokumenti. Në rastin kur provat kërkojnë pas lidhjes së një kontrate të caktuar (d.m.th., pas periudhës minimale katërmujore të monitorimit):

- kërkesa të tilla duhet të kryhen vetëm në rrethanat/rastet kur të dhënat, të cilat mblidhen për qëllime faturimi, rezultojnë se japin indikacione të përdorimit abuziv ose anormal, të palidhur me udhëtimet periodike në Ballkanin Perëndimor;
- provat e kërkuara duhet të përmbajnë vetëm ato që janë rreptësisht të nevojshme dhe proporcionale për të konfirmuar lidhjen e pajtimtarit me Shqipërinë (vendbanim apo lidhje të qëndrueshme); dhe
- pajtimtarit nuk duhet të ketë detyrim që të paraqesë dokumentacion të tillë në mënyrë të përsëritur dhe që nuk lidhet me një vlerësim të bazuar në risk të probabilitetit/mundësisë të përdorimit abuziv ose anormal të shërbimeve roaming nga pajtimtari.

2. Mekanizmi i kontrollit dhe treguesit objektivë

26.Neni 4 (4), i Rregullores së FUP përcakton që operatorët celularë mund të zbatojnë mekanizma të kontrollit të drejtë, të arsyeshëm dhe proporcionalë, të bazuar në tregues objektivë, që lidhen me riskun e përdorimit abuziv ose anormal të roaming-ut, që dalin jashtë kontekstit të udhëtimeve periodike në Ballkanin Perëndimor.

27.Në lidhje me treguesit objektivë që mund të përdoren nga operatori për të identifikuar rreziqet e përdorimit abuziv ose anormal, rregullorja e FUP përcakton dy lloje të tyre:

- i. kriteri i mbizotërimit të konsumit të shërbimeve celulare roaming në Ballkanin Perëndimor ose pranisë në vendet e Ballkanit Perëndimor ndaj konsumit/pranisë në Shqipëri;
- ii. tregues të tjerë objektivë;
 - pasiviteti i gjatë i një karte të caktuar SIM që shoqërohet me përdorimin e saj kryesisht, apo edhe ekskluzivisht, për roaming;
 - pajtimin dhe përdorimin sekuencial të shumë kartave SIM (multiple SIM) nga i njëjti klient gjatë roaming-ut.

28.Në lidhje me llojin e parë të treguesve objektivë, në përputhje me nenin 4 (4), nënparagrafin 2 të Rregullores së FUP, një MNO mund të marrë masa për të përcaktuar nëse një klient ka mbizotërim të konsumit të shërbimeve celulare në Shqipëri në raport me roaming në vendet e Ballkanit Perëndimor ose prezencë/prania e tij në Shqipëri mbizotëron ndaj asaj në vendet e Ballkanit Perëndimor. Këta tregues duhet të vëzhgohen në mënyrë kumulative (neni 4 (4), nënparagrafi 3 i Rregullores së FUP).

29.Në lidhje me llojin e dytë të treguesve objektivë, treguesit e tjerë objektivë që mund të përdoren janë përfshirë në mënyrë shteruese në nënparagrafin 7, të nenit 4 (4) të Rregullores së FUP, dhe i referohen pasivitetit të gjatë të një karte të caktuar SIM të shoqëruar me përdorim kryesisht, madje ekskluziv, në roaming, dhe pajtimin dhe përdorimin sekuencial të shumë kartave SIM nga i njëjti klient në roaming.

i) Mbizotërimi i konsumit ose prezencës në Shqipëri ndaj konsumit ose prezencës në roaming

30.Rregullorja e FUP përcakton se treguesit objektivë mund të përfshijnë masa nga operatori për të përcaktuar nëse konsumi i shërbimeve celulare në Shqipëri mbizotëron ndaj konsumit në roaming në Ballkanin Perëndimor, ose prania/prezencë e pajtimtarit në Shqipëri mbizotëron ndaj asaj në Ballkanin Perëndimor. Këto tregues duhet të monitorohen nga operatori në mënyrë kumulative si dhe për një periudhë kohore prej të paktën katër muajsh (këtu e më poshtë referuar si “periudha e monitorimit”).

31.Në lidhje me termin “mbizotëron”, AKEP sqaron se mbizotërimi i konsumit të shërbimeve celulare në roaming në Ballkanin Perëndimor në raport me konsumin e shërbimeve në Shqipëri, do të konsiderohet kur pajtimtari konsumon më shumë se 50% të shërbimeve celulare në roaming në Ballkanin Perëndimor gjatë periudhës së monitorimit. I njëjti arsyetim vlen respektivisht edhe për mbizotërimin e prezencës në roaming në Ballkanin Perëndimor të pajtimtarit në raport me Shqipërinë. Gjithashtu, konsumi apo prezencë e pajtimtarit në vende të tjera, të ndryshme nga Ballkani Perëndimor, do të përfshihet sikundër është në Shqipëri, pasi pajtimtari kur është në roaming në një vend tjetër, p.sh., në Itali, nuk është duke përfituruar shërbime të rregulluara roaming me regjimin RLAH. Rregullorja përcakton më tej se çdo ditë, kur një klient/pajtimtar roaming është futur (loguar) në rrjetin e operatorit në Shqipëri (për një kohëzgjatje të çfarëdoshme), do të llogaritet si një ditë e pranisë brenda vendit të këtij klienti.

- 32.** Vlerësimi i mbizotërimit të prezencës në Shqipëri duhet të kryhet nga operatori në bazë të të dhënave që ai disponon. Për shembull, nëse klienti nuk është loguar në ndonjë rrjet gjatë një dite (p.sh., pajisja celulare është fikur), një ditë e tillë nuk duhet të merret parasysh në përcaktimin nëse ekziston mbizotërim i pranishëm në Shqipëri/Ballkan Perëndimor ose jo. Në këtë rast, ofruesi i roaming duhet të vlerësojë, në bazë të ditëve gjatë së cilëve klienti është loguar në një rrjet, nëse ka pasur më shumë ditë të prezencës në Shqipëri ndaj prezencës në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.
- 33.** Treguesit që lidhen me mbizotërimin e konsumit ose prezencës duhet të monitorohen në mënyrë kumulative dhe për një periudhë kohore prej të paktën katër muajsh. Pra, nëse gjatë periudhës së monitorimit pajtimtari rezulton me mbizotërim të konsumit në Shqipëri ose mbizotërim të prezencës në Shqipëri, kjo do të konsiderohet si provë e përdorimit jo abuziv dhe jo anormal të shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë në Ballkanin Perëndimor.
- 34.** Operatorët mund të shqyrtojnë në çdo kohë nëse një klient ka pasur mbizotërim të konsumit ose prezencës brenda vendit gjatë periudhës së vëzhgimit, e cila është të paktën katër muaj të njëpasnjëshëm, dhe kjo duhet bërë në përputhje me kushtet e FUP-it në fuqi të operatorit. Pra, për të paralajmëruar pajtimtarin për aplikimin e tarifave shtesë roaming (*surcharges*), operatori duhet të jetë në gjendje të tregojë se pajtimtari nuk ka as mbizotërim të konsumit brenda vendit, as mbizotërim të prezencës në Shqipëri gjatë katër ose më shumë muajve të fundit të mëparshëm dhe konsektiv. Për qëllim të dërgimit të njoftimeve paralajmëruese dhe aplikimit të tarifave shtesë të roaming-ut (klientëve ekzistues dhe të rinj), operatori nuk mund të përdorë asnjë periudhë monitorimi më të shkurtër se katër muaj.
- 35.** Kriteri i konsumit mbizotërues mund të lidhet me një ose më shumë shërbime celulare me pakicë. Operatori mund të përcaktojë konsumin mbizotërues sipas shërbimeve roaming të rregulluar me pakicë (thirrje zanore, SMS, të dhëna) në mënyrë individuale dhe prezencën mbizotëruese brenda vendit, sipas udhëzimeve të mësipërme, dhe mund të dërgojë një njoftim paralajmërues dhe të aplikojë tarifë shtesë (*surcharge*) pas këtij njoftimi për shërbimin (shërbimet) roaming me pakicë, për të cilin/cilët është evidentuar rreziku i përdorimit abuziv ose anormal gjatë periudhës së monitorimit.

ii) Tregues të tjerë objektivë

- 36.** Nënparagrafi i fundit i nenit 4/4, të Rregullores së FUP si tregues të tjerë objektivë të përdorimit abuziv ose anormal të shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë periudhë të gjatë pasiviteti apo inaktiviteti të një karte SIM e lidhur dhe me përdorimin kryesisht, apo dhe ekskluzivisht në roaming në Ballkanin Perëndimor, si dhe pajtimin në shërbime celulare dhe përdorimin sekuencial të kartave të shumta SIM nga i njëjti klient gjatë roaming-ut në Ballkanin Perëndimor.
- 37.** AKEP sqaron se "pasivitet/inaktivitet" do të thotë që karta SIM nuk është përdorur për të bërë ose marrë thirrje, dërgimin e SMS-ve apo për shërbimet e të dhënave; ose kur karta SIM virtualisht nuk është përdorur. Pasiviteti i një karte SIM mund të ndodhë gjatë një periudhe të

vetme të vazhdueshme, që mund të jetë dy ose tre muaj, ose periudha sekuenciale të pasivitetit brenda vendit (disa javë) e shoqëruar me përdorimin e saj kryesisht në roaming në Ballkanin Perëndimor. AKEP rekomandon që, për të monitoruar një përdorim apo mospërdorim të tillë të përdoret një periudhë katër mujore në përputhje me rregullin e zbatueshëm për treguesit e prezencës dhe konsumit brenda vendit të shërbimeve celulare.

38. AKEP sqaron se treguesi objektiv "pajtimi dhe përdorimi sekuencial i shumë kartave SIM nga i njëjti klient gjatë roaming" mund të vlerësohet nga operatorët pa iu nënshtruar ndonjë detyrimi për periudhë minimale monitorimi.

39. Udhëzimet/njoftimet paralajmëruese që duhet t'u jepen pajtimtarëve kur modeli i sjelljes së tyre tregon rrezik të përdorimit anormal ose abuziv, janë pjesë e Kapitullit VIII (Udhëzimet 123 deri 129).

3. Rishitje e organizuar e kartave SIM

40. Në përputhje me nenin 4 (5), të Rregullores së FUP, operatori celular ka të drejtë të marrë masa të menjëhershme proporcionale në rast të rishitjes së organizuar të kartave SIM për të siguruar përputhmërinë me të gjitha kushtet e kontratës përkatëse të pajtimit. Rishitja e organizuar ndodh kur një numër kartash SIM bëhen objekt i rishitjes së organizuar për persona që nuk banojnë në mënyrë efektive në Shqipëri ose nuk kanë lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë, për përdorimin e tyre për qëllime të ndryshme nga përdorimi normal i shërbimeve roaming gjatë udhëtimeve periodike në vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto masa mund të jenë në nivelin e shitjes me shumicë ose me pakicë, në përputhje me përcaktimet përkatëse për shkeljen e kushteve të kontratës të evidentuar nga operatori celular si ofruesi i roaming-ut.

4. Politika e përdorimit të drejtë (FUP) në lidhje me paketat e hapura të të dhënave

41. Në bazë të përkufizimit në pikën 2/c, të nenit 2, të Rregullores së FUP, ekzistojnë dy lloje paketash të hapura të të dhënave:

- Paketa tarifore me internet pa limit;
- Paketa tarifore ku çmimi i derivuar (implicit) për njësi për të dhënat brenda vendit është më i ulët se tarifa maksimale e rregulluar me shumicë të roaming (referuar në pikën 3 të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, sipas periudhave përkatëse).

42. Në ndryshim nga planet e tjera tarifore, paketat e hapura kanë më shumë mundësi të bëhen objekt i rishitjes së organizuar, ose përdorimit anormal apo abuziv të shërbimeve roaming. Kjo mund të çojë në zhdukjen nga tregun vendas i planeve të tilla tarifore dhe përdorimin e tyre për roaming në Ballkanin Perëndimor. Prandaj, në bazë të përcaktimeve të Rregullores së FUP, përveç masave të tjera të FUP (vendbanimi i përhershëm, lidhjet e qëndrueshme dhe mekanizmi i kontrollit të bazuar në treguesit objektivë që lidhen me rrezikun e përdorimit abuziv ose anormal të shërbimeve roaming për qëllime të ndryshme nga udhëtimi periodik në

Ballkanin Perëndimor, udhëzimet më sipër), operatorët kanë të drejtë të zbatojnë kufij/limite të vëllimit të shërbimit për paketat e hapura të të dhënave.

43. Për të përcaktuar sasinë minimale të përdorimit të drejtë të njësive të shërbimit të rregulluar të të dhënave roaming të përfshira në tarifën fikse periodike dhe që mund të aplikohen në paketat e hapura, janë të nevojshme tre hapa:

- identifikimi i tarifës me pakicë brenda vendit të shërbimeve celulare që do të aplikohet në llogaritjen për të përcaktuar nëse paketa tarifore është një paketë e hapur e të dhënave, dhe vëllimin minimal të përdorimit të drejtë të shërbimeve roaming të të dhënave që shoqërohen me paketën e hapur (shiko hapat më poshtë);
- identifikimi nëse një paketë mund të konsiderohet një paketë e hapur;
- llogaritjen për të përcaktuar vëllimin minimal të përdorimit të drejtë të njësive të përfshira në paketë dhe që mund të përdoret në roaming në Ballkanin Perëndimor me paketën e hapur përkatëse (këtu e më poshtë "sasia e lejuar e të dhënave në roaming")

44. Në fillim duhet të theksohet se në llogaritjet e nevojshme për të vlerësuar nëse një paketë tarifore është një paketë e kufizuar apo paketë e hapur e të dhënave, tarifa me pakicë brenda vendit duhet të pjesëtohet vetëm me vëllimin/sasinë e shërbimeve të të dhënave të përfshira në paketë (d.m.th., sasia e minutave të thirrjeve dhe SMS-ve të përfshira në paketë duhet të përjashtohen nga llogaritja).

45. AKEP sqaron se, në rastin e paketave brenda vendit, për të cilat, shpejtësia e internetit (brenda vendit) reduktohet pasi arrihet një nivel i caktuar i konsumit të njësive të të dhënave të përfshira në paketë, ky kufi i të dhënave në të vërtetë nuk e kufizon sasinë e konsumuar të të dhënave dhe prandaj këto lloje paketash mund të trajtohen si paketa të hapura me internet pa limit (të pakufizuara), për qëllimet e parashikuara në nenin 2, të Rregullores së FUP.

i) Përkufizimi dhe përcaktimi i tarifës me pakicë brenda vendit i paketave të hapura të të dhënave

46. Për përcaktimin nëse një plan tarifor për një shërbim të komunikimit celular që përfshin sasi të kufizuara të të dhënave është një paketë e hapur e të dhënave, dhe/ose për përcaktimin e sasisë minimale të të dhënave që mund të përdoren në roaming në Ballkanin Perëndimor pa tarifë ekstra, pra, me RLAH (për të gjitha paketat e hapura, d.m.th., përfshirë edhe paketat me internet pa limit), tarifa përkatëse me pakicë brenda vendit është tarifa fikse periodike që paguhet për shërbimet celulare me pakicë të përfshira në planin tarifor. Shërbimet celulare me pakicë përkufizohen si shërbime të komunikimeve publike celulare të ofruara për përdoruesit fundorë, duke përfshirë shërbimet e thirrjeve, SMS-ve dhe të të dhënave.

47. Në rast se tarifa përkatëse brenda vendit përfshin shërbime të ndryshme nga shërbimet celulare me pakicë, siç janë shërbimet e komunikimeve elektronike nga rrjete fikse, nënparagrafi i dytë, i nenit 4/2, të Rregullores së FUP përcakton që tarifa me pakicë brenda vendit e paketës së të

dhënave, do të përcaktohet, duke marrë parasysh çmimin e aplikuar (pa TVSH) për shitjen më vete të elementit të shërbimeve me pakicë celulare pjesë e paketës, nëse është e disponueshme, ose çmimin për shitjen më vete (*stand alone*) të shërbimeve të tilla me të njëjtat karakteristika. Pra, si tarifë referencë brenda do të shërbejë tarifa përkatëse e shitjes së elementit të shërbimit celulare më vete, dhe jo diferenca midis tarifës së përgjithshme të paketës së integruar dhe tarifës së shitjes më vete të shërbimit të rrjetit fiks.

48. Përfshirja në paketë apo subvencionimi i aparatit celular duhet të konsiderohet si një shërbim jo-celular (shërbime të tjera jo-celulare mund të jenë shërbimet *cloud*, shërbime të lajmeve, shërbime të aksesit në rrjet fiks, etj.). Në këtë rast, operatori mund të zgjedhë të marrë si referencë dhe të aplikojë tarifën me pakicë brenda vendit për shitjen më vete të komponentit të shërbimit celular (p.sh., paketa vetëm me shërbim celular pa aparat celular apo shërbime e tjera jo celulare) ose tarifën me pakicë brenda vendit, për shitjen e shërbimeve të tilla me të njëjtat karakteristika (p.sh., paketa me të njëjtën sasi minutash të thirrjeve, SMS-ve dhe të dhënave). Në rast se operatori nuk ofron shitjen më vete të komponentit të shërbimit celular me të njëjtat karakteristika, operatori duhet të gjejë një zgjidhje në bashkëpunim me AKEP, për të përcaktuar tarifën përkatëse celulare me pakicë në linjë me Rregulloren e FUP.

49. Sipas pikës 2/b, të nenit 2, të Rregullores së FUP, përkufizimi i shërbimeve celulare me pakicë përfshin shërbime të komunikimeve celulare si thirrje, SMS dhe shërbime të të dhënave. Prandaj, për paketat që përfshijnë dy ose më shumë shërbime celulare (thirrje, SMS dhe/ose shërbime të të dhënave) duhet të përdoret tarifa e plotë e paketës për këto shërbime, dhe operatorëve nuk u lejohej të përdorin tarifa të tjera të shitjes më vete të të dhënave (paketa vetëm internet) ose paketa shtesë interneti (*add-on*) si referencë për llogaritjet për të përcaktuar nëse paketa është e hapur ose jo, si dhe për të përcaktuar sasi të përkatëse të të dhënave (internetit) të lejuara për t'u përdorur në roaming në Ballkanin Perëndimor me RLAH, pa tarifë shtesë.

50. Kur një plan tarifor përmban një skemë zbritje (skonto) të tarifës bazë në Shqipëri, AKEP sqaron se operatorët mund të përdorin si tarifë me pakicë brenda vendit ose tarifën pa zbritje ose tarifën me zbritje, për periudhën përkatëse të faturimit. Megjithatë, në rast se MNO përdor tarifën me skonto/zbritje si referencë, kjo lejohej vetëm për muajt/periudhat e faturimit kur ajo faturohet me zbritje në Shqipëri, ndërsa për muajt/periudhat e faturimit pa skonto në tarifë, si referencë (si për përcaktimin nëse është paketë e hapur ose jo, ashtu edhe për llogaritjen e njësisive të të dhënave të përfshira në paketë për roaming RLAH-pa tarifim shtesë) do të përdoret tarifa pa zbritje.

51. Kur klientët/pajtimtarët blejnë një paketë shtesë (*add-on*) mbi paketën e tyre për të përftuar sasi shtesë të shërbimeve celulare me pakicë përtej njësisive të përfshira në paketën e tyre, një shtesë e tillë do t'i nënshtrohet një trajtimi të veçantë, por të ngjashëm si dhe paketa bazë, për qëllimet e përcaktimit nëse operatori celular mund të aplikojë limite për konsumin e shërbimeve të të dhënave në roaming, në përputhje me nenin 4 (2), të Rregullores së FUP.

52. Kur një operator ofron për pajtimtarin paketa të tjera shtesë (*add-ons*) si p.sh., të lidhura me sasinë e shërbimit (p.sh. ,si promocion i veçantë), pajtimtari/klienti do të jetë në gjendje ta konsumojë këtë shtesë në të njëjtat kushte si brenda vendit.

ii) Shembuj të paketave të hapura të të dhënave të ndryshme nga paketat me internet pa limit

53. AKEP më poshtë ka përfshirë disa shembuj me sqarime më të detajuara për përkufizimin e paketave të hapura të të dhënave (pika 2/a, e nenit 2, të Rregullores së FUP) :

• **Shembull 1:**

Tarifa me pakicë për një paketë shërbimi celular brenda vendit, që përfshin 3 GB të dhëna (Internet) është 1000 ALL në muaj, pa TVSH.

Tarifa maksimale me shumicë për të dhëna në roaming në Ballkanin Perëndimor më 1.7.2021 - 31.12.2021 është 0.0077 Euro/MB (7.885 Euro/GB) apo 970 ALL për GB².

Duke pjesëtuar tarifën e përgjithshme të paketës 1000 ALL me sasinë e internetit të përfshirë në paketë 3 GB, çmimi për njësi i internetit brenda vendit i përfshirë në këtë paketë rezulton të jetë **333 ALL/GB**. Kjo vlerë (333 ALL/GB) është më e ulët se tarifa maksimale me shumicë për të dhëna në roaming prej 970 ALL/GB. Prandaj, një paketë e tillë mund të konsiderohet si paketë e hapur të dhënash.

• **Shembull 2:**

Tarifa me pakicë për një paketë shërbimi celular brenda vendit që përfshin 1 GB të dhëna (Internet) është 1000 ALL/muaj, pa TVSH. Tarifa maksimale me shumicë për të dhëna në roaming në Ballkanin Perëndimor më 1.7.2021 - 31.12.2021 është 0.0077 Euro/MB (7.885 Euro/GB) apo 970 ALL/GB.

Duke pjesëtuar tarifën e përgjithshme të paketës 1000 ALL me sasinë e internetit të përfshirë në paketë 1 GB, çmimi për njësi i internetit brenda vendit i përfshirë në këtë paketë rezulton të jetë 1000 ALL/GB. Kjo vlerë (1000 ALL/GB) është më e lartë se tarifa maksimale me shumicë për të dhëna në roaming prej 970 ALL/GB. Prandaj, një paketë e tillë **nuk konsiderohet paketë e hapur të dhënash.**

iii) Përcaktimi i kufirit minimal të sasisë së të dhënave për paketat e hapura që mund të aplikohet në roaming BP

54. Për paketat e shërbimeve celulare që nuk plotësojnë kushtet për t'u konsideruar paketa të hapura të dhënash (p.sh., rasti i dytë në paragrafin e mësipërm), operatori ka detyrim që të mos vendosë kufi për përdorim të sasisë së përfshirë në paketë në roaming në Ballkanin Perëndimor.

² Kjo tarifë maksimale me shumicë është e aplikueshme për periudhën 1.7.2021 - 31.12.2021. Në bazë të vendimeve të AKEP nr.22-24, datë 24.6.2019, kursi i këmbimit i përdorur për konvertimin Euro/Lek për këtë periudhë është 1 Euro=123 Lekë. Tarifa maksimale me shumicë për të dhënat do të reduktohet në periudhat e mëvonshme sipas vendimeve të cituara të AKEP.

Pra, pajtimtari ka të drejtë të konsumojë në roaming në Ballkanin Perëndimor dhe të gjithë sasinë e përfshirë të të dhënave (p.sh., 1GB rasti i mësipërm), duke respektuar njëkohësisht kushtet e tjera të FUP. Ndërsa, për paketat brenda vendit që plotësojnë kushtin e paketës së hapur të të dhënave, operatori ka të drejtë të aplikojë një kufi për sasinë e të dhënave që pajtimtari mund të konsumojë në roaming në Ballkanin Perëndimor pa tarifë shtesë roaming. Sipas pikës 2, të nenit 4, të Rregullores së FUP, sasia e të dhënave që pajtimtari mund të konsumojë në Ballkanin Perëndimor me RLAH (pra pa tarifë shtesë) është sa dyfishi i vlerës që rezulton nga pjesëtimi i tarifës së përgjithshme të paketës së shërbimeve celulare (pa TVSH) me tarifën përkatëse maksimale me shumicë të roaming-ut të të dhënave në Ballkanin Perëndimor (sipas pikës 3 të vendimeve nr. 22-24/2019, të AKEP dhe periudhave përkatëse). Ky limit nuk cenon apo prek kufijtë e zbatueshëm për të dhënat brenda vendit.

55. AKEP sqaron se në praktikë kjo nënkupton që për oferta të kufizuara mund të ketë dy lloje të ndryshme paketash të hapura të të dhënave :

- i. Paketat e hapura të të dhënave për të cilat sasia minimale e të dhënave e lejuar për roaming në Ballkanin Perëndimor me RLAH (llogaritur siç përshkruhet në përputhje me nenin 4 (2), të Rregullores së FUP) rezulton të jetë **më e madhe** se sasia e të dhënave të lejuara/përfshira për konsum brenda vendit: Në këtë skenar klienti/pajtimtari roaming do të jetë në gjendje të konsumojë në roaming në Ballkanin Perëndimor me tarifë RLAH (pa tarifë ekstra) **të gjithë sasinë e të dhënave të përfshira/lejuara për konsum brenda vendit**. Pas konsumit të këtij kufiri kombëtar të të dhënave, përdorimi shtesë i internetit në roaming në Ballkanin Perëndimor do të tarifohet me tarifën përkatëse për njësi (jashtë pakete) të internetit brenda vendit, deri sa të arrihet kufiri i të dhënave për roaming në Ballkanin Perëndimor. Pasi arrihet ky kufi roaming-u i të dhënave, operatori mund të aplikojë tarifë shtesë apo *surcharge* (max.970 ALL/GB pa TVSH për 1.7.2021 - 31.12.2021) mbi tarifën përkatëse për njësi të internetit brenda vendit. Shuma e tarifës shtesë për roaming të aplikuar me tarifën për njësi brenda vendit nuk duhet të jetë më e lartë se tavanet e përcaktuara për tarifatat totale me pakicë në roaming sipas pikës 3 dhe 4 të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP dhe periudhave përkatëse si dhe në Rregulloren e FUP (neni 1, pika 3). Në rastet kur, për paketën tarifore brenda vendit në fjalë, operatori aplikon politikën e ndërprerjes së ofrimit të internetit brenda vendit pasi arrihet sasia e njësive të të dhënave të përfshira në konsum brenda vendit (pra nuk vijon ofrimin e internetit me shpejtësi të reduktuar), i njëjti mekanizëm duhet të përdoret edhe kur klientët janë në roaming në Ballkanin Perëndimor. Nëse klienti/pajtimtari blen një paketë shtesë (*add-on*), kjo paketë do të trajtohet në përputhje me **Udhëzimin 51**.
- ii. Paketa e hapura e të dhënave për të cilat sasia minimale e të dhënave të lejuara për roaming në Ballkanin Perëndimor me RLAH (llogaritur siç përshkruhet në përputhje me nenin 4 (2), të Rregullores së FUP) rezulton të jetë **më e vogël** se sasia e të dhënave të lejuara/përfshira për konsum brenda vendit: Në këtë skenar klienti/pajtimtari roaming do të jetë në gjendje të konsumojë në roaming në Ballkanin Perëndimor me

tarifë RLAH (pa tarifë ekstra) **kufirin e llogaritur të të dhënave për roaming**, i cili është më i ulët se ai i lejuar brenda vendit. Pas tejkalimit të limitit në roaming, operatorët mund të aplikojnë një tarifë shtesë roaming (*surcharge*) mbi tarifën përkatëse brenda vendit deri sa të arrihet limiti i të dhënave brenda vendit. Pas tejkalimit të limit brenda vendit, operatorët mund të aplikojnë një tarifë shtesë mbi tarifën përkatëse brenda vendit për njësi të dhënash (*out of bundle*). Shuma e tarifës brenda vendit me tarifën shtesë roaming (tarifa totale me pakicë e rregulluar roaming) nuk duhet të jetë më e lartë se tavanet e përcaktuara për tarifatat totale me pakicë në roaming sipas pikës 3 dhe 4 të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP dhe periudhave përkatëse si dhe në pika 3 e enit 1 të Rregullores së FUP (për më shumë shiko Udhëzimin 72).

56. AKEP më poshtë ka dhënë disa shembuj të llogaritjes së kufirit të lejuar të të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor (duke përdorur tarifën maksimale me shumicë për të dhënat në roaming 0.0077 Euro/MB (7,885 Euro/GB) apo 970 ALL/GB (pa TVSH) dhe të aplikueshme për 1.7.2021 - 31.12.2021):

- **Shembull 3:**

Një plan tarifor celular prej 9000 ALL/muaj (pa TVSH) ka të përfshirë sasi pa limit thirrje, SMS dhe të dhëna (internet).

- Sipas Rregullores së FUP ky është plan tarifor i hapur, pasi përfshin sasi të pakufizuara të njësive të të dhënave.
- Operatori mund (ka të drejtë) të aplikojë një limit për konsumin e të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor prej të paktën 18.56 GB $((9000 / 970) * 2)$.
- *Pas tejkalimit të limitit në roaming prej 18.56 GB, operatori ka të drejtë të aplikojë tarifë shtesë roaming (jo më të madhe se 970 ALL/GB).*

Kufizimi i shpejtësisë:

Në rast se paketa me internet pa limit brenda vendit përfshin si politikë të drejtë reduktimin e shpejtësisë pas konsumit të një sasi/limit të caktuar të dhënash, operatori ka të drejtë të aplikojë të njëjtin mekanizëm të reduktimit të shpejtësisë edhe për roamingun në BP.

- **Shembull 4:**

Një paketë me tarifë 1000 ALL/muaj (pa TVSH) që përfshin 2 GB internet.

- Tarifa me pakicë brenda vendit është 1000 ALL pasi në paketë nuk përfshihet ndonjë shërbim tjetër jo-celular.
- Kjo paketë është një paketë e hapur e të dhënave pasi tarifa për njësi (1 GB) e internetit është më e vogël se tarifa maksimale me shumicë e roaming-ut për të dhëna: $1000/2 = 500 \text{ ALL} < 970 \text{ ALL}$.
- Kufiri/limit për konsumin e të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor që mund të aplikojë operatori për këtë paketë është **2.06 GB** $((1000/970)*2)$. Pra, një klient që

përdor këtë paketë do të jetë në gjendje të konsumojë minimalisht 2.06 GB në roaming në Ballkanin Perëndimor.

- Meqenëse kufiri (sasia limit) e të dhënave të lejuara për roaming në Ballkanin Perëndimor (2.06 GB) është më e madhe se sa sasia e njësive të të dhënave të përfshira për konsum brenda vendit (2 GB), ky pajtimtar do të jetë në gjendje të konsumojë internet në roaming me çmimin me pakicë brenda vendit (RLAH, pra, pa tarifë shtesë roaming), derisa sa konsumi i internetit në roaming të arrijë kufirin brenda vendit prej 2 GB, duke zbritur njësitë e përdoruara në roaming;
- Pasi të tejkalohet limiti 2GB, për konsumin e internetit në roaming aplikohet tarifa përkatëse për njësi si brenda vendit (pa tarifë shtesë roaming) deri sa konsumi të arrijë në 2.06 GB;
- Pas këtij limiti roaming 2.06 GB, operatori ka të drejtë të aplikojë tarifë shtesë (*surcharge*) për njësi mbi tarifën përkatëse për njësi brenda vendit.

- **Shembull 5:**

Një paketë brenda vendit me tarifë 2000 ALL/muaj (pa TVSH), përmban sasi pa limit thirrje dhe SMS dhe 7 GB të dhëna (internet).

- Kjo paketë është një paketë e hapur e të dhënave pasi tarifa për njësi (1 GB) e internetit është më e vogël se tarifa maksimale me shumicë e roaming-ut për të dhëna: $2000/7 = 286 \text{ ALL} < 970 \text{ ALL}$.
- Kufiri/limit për konsumin e të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor që mund të aplikojë operatori për këtë paketë është 4.12 GB $((2000/970)*2)$. Pra, një klient që përdor këtë paketë do të jetë në gjendje të konsumojë minimalisht 4.12 GB në roaming në Ballkanin Perëndimor, pa tarifë shtesë.
- *Pas tejkalimit të limitit në roaming prej 4.12 GB, operatori ka të drejtë të tarifojë njësitë shtesë të të dhënave në roaming në BP me tarifë shtesë roaming (jo më të madhe se 970 ALL) deri sa të arrijë limitin brenda vendit prej 7GB.*
- *Pas tejkalimit dhe të limitit brenda vendit prej 7GB, operatori ka të drejtë të aplikojë tarifën shtesë roaming+tarifën përkatëse për njësi (out of bundle) brenda vendit.*

- **Shembull 6**

Një paketë e integruar që përmban shërbime celulare dhe shërbime aksesit në internet nga rrjeti fikse, ka tarifë 4000 ALL/muaj, pa TVSH. Shërbimi celular përfshin thirrje dhe SMS pa limit dhe 10 GB internet celular.

Meqenëse paketa përfshin një shërbim jo-celular, si tarifë referencë brenda vendit për shërbimin celular mund të përdoret tarifa me pakicë e shitjes më vete (*stand alone*) të një pakete shërbimi celular me të njëjtat karakteristika, p.sh., operatori ofron i kësaj pakete të integruar (celular dhe fikse) ofron dhe një paketë të veçantë vetëm me shërbim celular që përmban vetëm thirrje dhe SMS pa limit, dhe 10 GB internet celular, me tarifë 2500

ALL/muaj pa TVSH. Në këtë rast, si tarifë referencë brenda vendit për llogaritje për internetin në roaming në Ballkanin Perëndimor, do të përdoret tarifa 2500 ALL.

Kjo paketë është një paketë e hapur e të dhënave, pasi $2500/10 = 250 \text{ ALL} < 970 \text{ ALL}$.

Një pajtimtar në roaming me këtë ofertë do të jetë në gjendje të konsumojë të paktën **5.15 GB ((2500 / 970) * 2)** në roaming në Ballkanin Perëndimor, pa ndonjë tarifë shtesë, pra RLAH.

- **Shembull 7**

Një paketë shërbim celular me tarifë 600 ALL/muaj (pa TVSH), përfshin ose 1000 minuta ose 1000 SMS ose 1000 MB ose ndonjë kombinim me një sasi maksimale kumulative të këtyre shërbimeve prej 1000 njësisish:

Kjo paketë tarifore është një paketë e hapur, pasi $600/1=600 < 970$

Ky pajtimtar duhet të jetë në gjendje të konsumojë të paktën **1.24 GB** kur është në roaming ((600 / 970) * 2).

Meqenëse sasia limit e të dhënave të lejuara për t'u përdorur në roaming në Ballkanin Perëndimor (1.24) është më e madhe se ajo që mund të përdoret brenda vendit (1GB), pajtimtari do të jetë në gjendje të konsumojë në roaming deri në 1GB pa tarifë shtesë, dhe pas kalimit të këtij limiti brenda vendit, sasi shtesë deri në limitin roaming 1.24 GB do të tarifohen sipas mekanizimit përkatës brenda vendit (p.sh., me tarifën përkatëse për njësi/MB (*out of bundle*) të internetit brenda vendit).

57.Për të shmangur çdo dyshim apo paqartësi, AKEP sqaron se mekanizmat e kontrollit të parashikuar në nenin 4/4, të Rregullores së FUP dhe sqarimet e dhëna në Udhëzimet 26-39 më sipër, mund të aplikohen edhe për paketat e hapura të të dhënave.

58.Kurdo që një pajtimtar fillon të përdorë shërbimet e roaming-ut gjatë periudhës përkatëse të faturimit (midis fillimit dhe fundit të periudhës së faturimit/përdorimit të paketës) dhe pajtimtari ka përdorur tashmë një pjesë të sasive përkatëse të shërbimeve të përfshira në paketë brenda Shqipërisë, atëherë limiti përkatës i konsumit brenda vendit do të aplikohet pavarësisht limitit të FUP për roaming-un.

- **Shembull 8:**

Një pajtimtar ka një paketë për përdorim brenda vendi me 5 GB dhe në momentin që fillon të përdorë shërbimet roaming në Ballkanin Perëndimor i kanë mbetur vetëm 2 GB për përdorim brenda vendit. Nëse pajtimtari përdor në roaming këto 2GB duke arritur limitin brenda vendit 5GB, por është ende brenda limitit FUP të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor (p.sh., ky limit është 3GB), atëherë operatori ka detyrim që pas arritjes së kufirit 5GB të aplikojë për pajtimtarin të njëjtin mekanizëm tarifimi sikundër ai të konsumonte internetin në Shqipëri, d.m.th., të aplikojë tarifën standarde për njësi (MB) për tarifim jashtë pakete (*out of bundle*), ose mund të ndërpresë ofrimin e shërbimit të internetit. Ndërkohë, tarifa shtesë (*surcharge*) roaming mbi tarifën për njësi brenda vendit, mund të

aplikohet kur pajtimtari tejkalon limitin FUP të të dhënave roaming në Ballkanin Perëndimor (në këtë rast pasi ka përdorur 3GB në roaming).

5. Tarifat me parapagim

- 59.** Sipas nenit 2 (2) (d), të Rregullores së FUP, një plan tarifor me parapagim nënkupton një plan tarifor sipas të cilit shërbimet me pakicë celulare ofrohen nëpërmjet zbritjes nga kreditet e parapaguara nga pajtimtari të vlerave monetare përkatëse për çdo njësi shërbimi të konsumuar, d.m.th., tarifim me parapagim për njësi shërbimi, dhe, nga i cili, pajtimtari mund të tërhiqet pa penalitete pas përdorimit të plotë të tyre ose përfundimit të afatit të përdorimit të krediteve. Pra, në planet tarifore me parapagim për qëllime të FUP, përfshihen vetëm planet me parapagim që tarifohen me tarifa standarde për njësi shërbimi (minuta, SMS, dhe MB), Gjithashtu, në këtë kategori (plan tarifor me parapagim) nuk përfshihen as tarifat standarde për njësi shërbimi të aplikuara për përdoruesit e planeve me paspagim (*out-of-bundle*).
- 60.** Planet e tjera tarifore të ofruara për pajtimtarët me parapagim, të tilla si planet tarifore që përfshijnë një sasi shërbimesh celulare kundrejt një tarife me parapagim (p.sh., oferta/paketat ditore, javore, mujore/30 ditore etj.), nuk duhet të konsiderohen si tarifa me parapagim për qëllimet e FUP. Në rastin e paketave të tilla, operatori mund të përcaktojë nëse ato mund të konsiderohen paketa të hapura të të dhënave ose jo, sikundër për planet tarifore me paspagim.
- 61.** Në përputhje me nenin 4 (3), të Rregullores së FUP, për planet tarifore me parapagim (sipas përkufizimit për qëllime të FUP) operatorët celularë mund të kufizojnë sasinë e shërbimeve me pakicë të të dhënave që mund të konsumohet në roaming në Ballkanin Perëndimor me tarifim sipas çmimit me pakicë në Shqipëri, si një alternativë ndaj kërkesës për prova të pajtimtarit për vendbanim të përhershëm apo lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë, sipas nenit 4/1, të Rregullores së FUP (Udhëzimet 20-25). Kjo do të thotë që, kur operatori aplikon një kufizim/limit të tillë të konsumit të shërbimeve në roaming në Ballkanin Perëndimor, ai nuk lejohet të aplikojë një mekanizëm FUP të bazuar në vendbanimin e përhershëm apo lidhjet e qëndrueshme të pajtimtarit me Shqipërinë. Ky limit i konsumit nga pajtimtari i të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor, duhet të llogaritet në momentin kur një përdorues i një plani tarifor me parapagim fillon të përdorë roaming-un në Ballkanin Perëndimor, d.m.th., kalon kufirin jashtë Shqipërisë dhe hyn në një vend tjetër të Ballkanit Perëndimor.
- 62.** Kufiri i konsumit të shërbimeve të të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor (shiko Udhëzimin 61) do të jetë i barabartë me vlerën e përfutur nga llogaritja e mëposhtme: Vlera e përgjithshme e kredit me parapagim të mbetur (pa TVSH), pjesëtuar me tarifën maksimale me shumicë të rregulluar të të dhënave roaming të aplikueshme sipas periudhave përkatëse (vendimet e AKEP me nr. 22-24/2019).
- 63.** Për llogaritjen sipas Udhëzimit 62, duhet të përdoret krediti i mbetur i pajtimtarit kur ai fillon të përdorë shërbimin roaming të të dhënave në një vend tjetër të Ballkanit Perëndimor. Kur një klient ndodhet tashmë në një vende të Ballkanit Perëndimor dhe kryen një rimbushje me

parapagim (pa blerë ofertë/paketë me parapagim), operatori duhet të rillogarisë sasinë e përdorimit të drejtë të të dhënave në roaming, dhe pajtimtari duhet të informohet për rillogaritjen. Në mënyrë të ngjashme, ky limit i rishikuar duhet të llogaritet duke pjesëtuar vlerën e përgjithshme të kreditimit (rimbushje) së parapaguar të mbetur (pa TVSH) me tavanin e aplikueshëm të shitjes me shumicë të të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor.

64. Pavarësisht kufirit të të dhënave për roaming të cituar më sipër, konsumimi i kreditit të parapaguar për thirrje ose mesazhe SMS, sipas tarifave përkatëse të aplikueshme, do të zvogëlojë kreditin e disponueshëm për përdorim të të dhënave në roaming gjatë të njëjtit udhëtim në Ballkanin Perëndimor.

65. Në përputhje me përcaktimet e nenit 6, të vendimeve të AKEP me nr. 22-24/2019, operatori celular duhet ta informojë pajtimtarin nëpërmjet informacionit të personalizuar tarifor për shërbimin e rregulluar të të dhënave në roaming, (shiko kapitullin VIII) në lidhje me sasinë/limitin e të dhënave që mund të përdorë pajtimtari në roaming në Ballkanin Perëndimor, (kur pajtimtari fillon të përdorë për herë të parë shërbimin e të dhënave në roaming në një vend të Ballkanit Perëndimor).

66. AKEP më poshtë ka dhënë disa shembuj për planet tarifore me parapagim dhe limitet përkatëse të të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor:

- **Shembull 9:**

Një përdorues plani tarifor me parapagim ka një kredit të mbetur prej 1000 ALL (pa TVSH) kur fillon të përdorë shërbimet e roaming të të dhënave në një vend të Ballkanit Perëndimor. Tarifa standarde me parapagim për përdorimin e internetit në Shqipëri nga pajtimtari është 20 ALL/MB (pa TVSH).

Me kreditin e mbetur në dispozicion, pajtimtari do të jetë në gjendje të konsumojë deri në 50 MB (**0.05 GB**) të dhëna (internet) brenda vendit, pra në Shqipëri.

Për periudhën 1.7.2021 - 30.6.2021, tarifa maksimale me shumicë për të dhënat në roaming në Ballkanin Perëndimor është 0.0077 Euro/MB (7,885 Euro/GB) apo 970 ALL/GB. Me kreditin e mbetur prej 1000 ALL, sasia e të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor e llogaritur në bazë të nenit 4 (3), të Rregullores së FUP për këtë pajtimtar do të ishte **1.03 GB** (1000/970).

Meqenëse limit/kufiri sasior i të dhënave që operatori mund të zbatojë për roaming në Ballkanin Perëndimor (1.03 GB) është më i madh se sasia e të dhënave që pajtimtari mund të konsumojë në Shqipëri (50 MB/0.05 GB) me kreditin e mbetur (1000 ALL), ky pajtimtar do të konsumojë internet në roaming në Ballkanin Perëndimor (me tarifën e aplikueshme në Shqipëri-20 ALL/MB) deri sa të përfundojë kreditin e tij.

Në këtë rast, operatori nuk mund të përdorë një kufi të drejtë përdorimi të të dhënave për roaming në Ballkanin Perëndimor, sepse kufiri sasior i të dhënave të përfshira për roaming në Ballkanin Perëndimor, të llogaritur sipas formulës së FUP është më i lartë se sasia e të dhënave që pajtimtari mund të konsumojë në Shqipëri me kreditin e mbetur. Operatori në këtë rast, në informacionin e personalizuar tarifor për internetin në roaming në Ballkanin

Perëndimor, nuk duhet të përfshijë informacion në lidhje me limitin e të dhënave në roaming.

Duhet të theksohet se ky shembull supozon se pajtimtari përdor vetëm shërbimin e të dhënave në roaming. Sidoqoftë, kur pajtimtari me tarifë më parapagim konsumon dhe shërbime të tjera celulare gjatë roaming-ut ose në Shqipëri (p.sh., SMS dhe/ose thirrje), vlerat përkatëse monetare të përdorimit do të debitohen/zbriten nga krediti i mbetur duke tarifuar çmimet përkatëse të aplikueshme në Shqipëri, dhe kjo nga ana e saj do të zvogëlojë kreditin në dispozicion për konsumin e shërbimeve të mëtejshme celulare me pakicë (d.m.th., të dhëna, SMS dhe thirrje zanore) si në roaming, ashtu edhe në Shqipëri.

- **Shembull 10:**

Një përdorues plani tarifor ka një kredit të mbetur prej 2000 ALL (pa TVSH) kur fillon të përdorë shërbimet e roaming të të dhënave në një vend të Ballkanit Perëndimor. Tarifa standarde me parapagim për përdorimin e internetit në Shqipëri nga pajtimtari është 500 ALL/GB (pa TVSH).

Me kreditin e mbetur në dispozicion, pajtimtari do të jetë në gjendje të konsumojë deri në **4 GB** të dhëna (internet) brenda vendit, pra në Shqipëri.

Për periudhën 1.7.2021 - 30.6.2021, tarifa maksimale me shumicë për të dhënat në roaming në Ballkanin Perëndimor është 0.0077 Euro/MB (7,885 Euro/GB) apo 970 ALL/GB. Me kreditin e mbetur prej 2000 ALL, sasia e të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor e llogaritur në bazë të nenit 4 (3), të Rregullores së FUP, për këtë pajtimtar do të ishte **2.06 GB**.

Meqenëse limit/kufiri sasior i të dhënave që operatori mund të zbatojë për roaming në Ballkanin Perëndimor (2.06 GB) është më i ulët se sasia e të dhënave që pajtimtari mund të konsumojë në Shqipëri (4 GB) me kreditin e mbetur (2000 ALL), operatori ka të drejtë të kufizojë përdorimin e internetit në roaming në Ballkanin Perëndimor të tarifuar me tarifën e aplikueshme në Shqipëri (500 ALL/GB) të këtij pajtimtari deri në **2.06 GB**.

Pasi pajtimtari arrin limitin 2.06 GB në roaming, operatori ka të drejtë të aplikojë tarifë shtesë (*surcharge*) roaming për njësitë shtesë të të dhënave të përdorura në roaming me tarifë: $500+970=1470$ ALL/GB.

Operatori në këtë rast të aplikimit të kufirit FUP në informacionin e personalizuar tarifor për internetin në roaming në Ballkanin Perëndimor duhet të përfshijë informacion në lidhje me limitin e të dhënave në roaming (2.06 GB).

Duhet të theksohet se ky shembull supozon se pajtimtari përdor vetëm shërbimin e të dhënave në roaming. Nëse pajtimtari përdor dhe shërbime të tjera, aplikohen sqarimet e dhëna në shembullin e mëparshëm.

67.Për të shmangur çdo dyshim apo paqartësi, AKEP sqaron se mekanizmat e kontrollit të parashikuar në nenin 4/4, të Rregullores së FUP, dhe sqarimet e dhëna në udhëzimet 26-39, mund të aplikohen edhe për planet tarifore me parapagim të diskutuara në këtë seksion.

V. Aplikimi i një tarife shtesë roaming (*surcharge*)

68. Vendimet e AKEP me nr.22-24/2019, të miratuara në kuadër të marrëveshjes rajonale të roaming-ut, synojnë heqjen e tarifave me pakicë të roaming-ut (tarifave shtesë) për pajtimtarët e operatorëve celularë të Republikës së Shqipërisë, kur këta pajtimtarë vizitojnë vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor duke filluar nga data 1 korrik 2021. Ndërsa në periudhën 1.7.2019 - 30.6.2021, operatorët celularë ishin të lejuar të aplikojnë një tarifë shtesë për roaming-un në vendet e Ballkanit Perëndimor mbi tarifën përkatëse të aplikuar brenda vendit, duke filluar nga 1.7.2021 operatorët janë të detyruar të aplikojnë vetëm tarifën përkatëse brenda vendit, pra pa tarifë shtesë për roaming në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, bazuar në vendimet e AKEP dhe në Rregulloren e FUP, mund të identifikohen dy raste kryesore ku operatorët mund/kanë të drejtë të aplikojnë tarifa shtesë (*surcharge*) për roaming-un në Ballkanin Perëndimor, mbi tarifën përkatëse të aplikueshme brenda vendit (kur pajtimtari është në Shqipëri):

- Tarifat shtesë mund të aplikohen kur shërbimet e rregulluara me pakicë të roaming-ut janë duke u përdorur mbi çdo kufi/limit apo në shkelje të FUP në përputhje me përcaktimet e vendimeve nr.22-24/2019 dhe Rregullores së FUP të AKEP.
- Tarifat shtesë mund të aplikohen për të siguruar qëndrueshmërinë e modelit të tarifimit brenda vendit të operatorëve celularë. Në këtë rast, tarifa shtesë duhet të autorizohet nga AKEP, në bazë të një kërkesë nga operatori celular, për autorizim për të aplikuar një tarifë shtesë (shiko Kapitullin XVI).

1. Tarifa shtesë për konsum shtesë mbi kufirin e FUP ose për shkelje të FUP

69. Për të shmangur çdo dyshim apo paqartësi, AKEP sqaron se, pavarësisht se prej datës 1.7.2021 hyn në fuqi regjimi RLAH për roaming-un në Ballkanin Perëndimor (heqja e tarifave shtesë me pakicë për roaming), ekzistojnë disa raste kur një operator celular ka të drejtë të aplikojë tarifa shtesë (*surcharges*) për pajtimtarin gjatë roaming-ut në vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat janë të lidhura me rastet e shkeljes së kushteve të përdorimit drejtë sipas Rregullores së FUP ose me tejkalimin e limitit/kufizimit sasior të përdorimit të të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor, si më poshtë:

- a. Klienti/pajtimtari nuk zotëron ose nuk dëshiron të ofrojë prova të dokumentuara të vendbanimit të përhershëm ose lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë (Kapitulli IV, Udhëzimet 20-25);
- b. Operatori celular si ofruesi i roaming-ut ka prova/të dhëna të vërtetuara se ekziston një rrezik i përdorimit abuziv ose anormal të shërbimeve roaming me regjimin RLAH nga pajtimtari/klienti përkatës (Kapitulli IV, Udhëzimet 26 deri 39);

- c. Klienti/pajtimtari i një pakete të hapur të të dhënave ka konsumuar të gjithë sasinë/njësitë e të dhënave të përfshira në limitin për përdorim në roaming në Ballkanin Perëndimor dhe është duke përdorur internetin përtej këtij limiti (Kapitulli IV, Udhëzimet 41 deri 58);
- d. Klienti/pajtimtari i një pakete tarifore me parapagim (sipas përkufizimit në Rregulloren e FUP) është duke konsumuar internet përtej limitit të të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor, të llogaritur sipas nenit 4/3, të Rregullores së FUP (limit që mund të përdoret si një alternativë në vend të dokumentacionit të kërkuar për vendbanim të përhershëm ose lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë, Kapitulli IV, Udhëzimet 59 deri 67).

70.Rastet a) dhe b) më sipër të shkeljes së rregullave të FUP mund të çojnë në aplikim nga operatori të tarifave shtesë të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor për të gjitha shërbimet roaming (thirrje, SMS dhe të dhëna). Ndërsa tejkalimi i limitit (sasisë së lejuar) të përdorimit të të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor në rastet c) dhe d) më sipër, mund të çojë në aplikim të tarifave shtesë roaming (*surchage*) vetëm për shërbimin me pakicë të të dhënave në roaming.

71.Në rast të aplikimit të tarifave shtesë roaming për paketat e hapura të të dhënave dhe paketat tarifore me parapagim, operatori celular ka të drejtë të aplikojë një tarifë shtesë roaming (mbi tarifën përkatëse brenda vendit) për shërbimin e internetit në roaming, menjëherë pasi të jetë konsumuar sasia e njërive të përfshira e të dhënave për roaming në Ballkanin Perëndimor për tarifim si në Shqipëri.

72.Në rast mosrespektimi të FUP-it, tarifat shtesë roaming që mund të aplikojnë operatorët celularë duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- niveli i tarifave shtesë për shërbimet me pakicë të rregulluara roaming të thirrjeve dalëse (të kryera), thirrje hyrëse (të marra), SMS të dërguara dhe të dhënave (internetit) nuk duhet të tejkalojë tarifat maksimale me shumicë roaming të specifikuar në Tabela 1, të nenit 3, të vendimeve të AKEP me nr. 22-24/2019. Për periudhën 1.7.2021 - 31.12.2021 këto tavane (pa TVSH) janë përkatësisht: **3.94 ALL/minutë për thirrje dalëse; 1.97 ALL/minutë për thirrje hyrëse; 1.23 ALL/SMS të dërguara; 0.95 ALL/MB për të dhëna.**
- tarifa totale me pakicë e aplikuar nga operatori celular për shërbimet e rregulluara të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor, e cila përfshin tarifën përkatëse brenda vendit në Republikën e Shqipërisë dhe tarifën shtesë për shërbimet e rregulluara të roaming-ut të specifikuar në paragrafin më sipër, nuk duhet të tejkalojë vlerat si vijon (pa TVSH): **23.37 ALL/min për thirrjet dalëse, 1.97 ALL/minutë për thirrje hyrëse ; 7.38 ALL/SMS të dërguar dhe 22.14 ALL/MB për të dhëna.**
- Tavanet e paragrafit të dytë të mësipërm për tarifat totale nuk aplikohen, nëse operatori nuk aplikon një tarifë shtesë roaming (*surchage*) mbi tarifën përkatëse brenda vendit (pra, operatori vijon me aplikimin vetëm të tarifës përkatëse brenda vendit).

2. Mungesë e provave të dokumentuar të vendbanimit të zakonshëm ose lidhjeje të qëndrueshme me Shqipërinë

73.Në rast se operatori kërkon prova dokumentare nga pajtimtari që vërtetojnë se pajtimtari është me vendbanim të përhershëm ose ka lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë (shiko Udhëzimet nr.20-25), dhe pajtimtari nuk paraqet këto prova (rasti (a) i Udhëzimit nr.69), operatori celular ka të drejtë të aplikojë tarifa shtesë për roaming për konsumin nga ky pajtimtar të shërbimeve të rregulluara të roaming-ut me pakicë në Ballkanin Perëndimor.

74.Për të shmangur çdo dyshim, AKEP sqaron se, në këto raste, operatori ka të drejtë të aplikojë tarifë shtesë për të gjitha planet tarifore celulare në roaming, përfshirë paketat e hapura të të dhënave, por përveç planeve tarifore me parapagim, për të cilat operatori aplikon një limit/kufizim sasior të përdorimit të të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor sipas nenit 4 (3), të Rregullores së FUP (në këtë rast aplikimi i operatorit i kufizimit sasior të të dhënave roaming në Ballkanin Perëndimor shërben si një mekanizëm alternativ FUP në vend të kërimit të provave dokumentare për vendbanim të përhershëm apo lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë).

75.Për këto raste, operatori ka të drejtë të aplikojë tarifën shtesë të roamingut për të gjitha shërbimet celulare me pakicë (d.m.th., thirrjet zanore, mesazhet SMS dhe të dhënat).

3. Operatori celular ka prova thelbësore se ekziston rreziku i përdorimit abuziv ose anormal i shërbimeve roaming që nuk lidhen me udhëtim periodik në Ballkanin Perëndimor

76.Në rast të aplikimit të situatës (b) të Udhëzimit 69, nëse operatori celular ka prova/të dhëna të vërtetuara se ekziston një rrezik i përdorimit abuziv ose anormal i shërbimeve roaming me regjimin RLAH nga pajtimtari/klienti përkatës (Udhëzimet 26 deri 39) dhe pasi operatori të ketë paralajmëruar pajtimtarin (Udhëzimet 123 deri 129), atëherë operatori celular ka të drejtë të aplikojë tarifë shtesë roaming-u, me kusht që pajtimtari nuk ka ndryshuar modelin/mënyrën e përdorimit të shërbimeve, pra vijon me përdorim abuziv/anormal.

77.Për të shmangur çdo dyshim, AKEP sqaron se, në këto raste operatori ka të drejtë të aplikojë tarifë shtesë për të gjitha planet tarifore celulare në roaming, përfshirë paketat e hapura të të dhënave dhe planet tarifore me parapagim. Në përputhje me Udhëzimi 35, operatori ka të drejtë të aplikojë tarifë shtesë roaming-u vetëm për shërbimin për të cilin ka evidentuar rrezik të përdorimit abuziv ose anormal.

4. Operatori celular ka prova thelbësore se një numër kartash SIM kanë qenë objekt i rishitjes së organizuar

78.Në përputhje me nenin 4 (5), të Rregullores së FUP, kur një operator celular ka prova se një numër kartash SIM kanë qenë objekt i rishitjes së organizuar për persona që nuk banojnë në mënyrë efektive në Shqipëri ose nuk kanë lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë (shiko

Udhëzimin 40), operatori mund të marrë masa të menjëhershme proporcionale, në mënyrë që të sigurojë përdorimin e kartave SIM në përputhje me të gjitha kushtet e kontratës përkatëse të pajtimit.

79. Në situata të tilla, operatori celular do të njoftojë AKEP për provat/evidencat që dëshmojnë abuzimin sistematik për rastin në fjalë dhe masat e marra për të siguruar respektimin e të gjitha kushteve të kontratës së pajtimit. Ky njoftim dërgohet në AKEP jo më vonë se koha kur operatori ndërmerr masa të tilla parandaluese.

Për arsye praktikiteti dhe me qëllim dhënien e përparësisë ndërmarrjes së veprimeve nga operatorët për të luftuar çdo lloj mashtrimi të tillë me kartat SIM, AKEP sugjeron që këto njoftime nga operatorët për AKEP të kryhen në baza mujore, pra në fillim të muajit për çdo masë të ndërmarrë në muajin e mëparshëm. Në këtë njoftim duhet të përfshihen dhe numrat celulare MSISDN të përfshirë në skema të tilla. Për rastet të tilla operatorët duhet të zbatojnë dhe detyrime të tjera për njoftime që janë të lidhura me çështjet e sigurisë së rrjetit.

80. AKEP vlerëson se, përveç rasteve të parashikuara nga kontrata e pajtimit, një nga masat që operatori celular mund të zbatojë për të siguruar respektimin e kushteve të kontratës, është aplikimi i tarifave shtesë roaming.

81. Për të shmangur çdo dyshim, AKEP sqaron se, sqarimet e mësipërme janë të aplikueshme për të gjitha llojet e ofertave celulare të shitjes me pakicë, përfshirë paketat e hapura të të dhënave dhe tarifatat me parapagim, si dhe për të gjitha shërbimet celulare të roaming të shitjes me pakicë.

5. Përdorimi aktual i të dhënave për roaming tejkalon kufirin e njësive minimale të të dhënave të paketës për roaming në Ballkanin Perëndimor me RLAH (pa tarifa shtesë roaming).

82. Në rast të situatës së referuar në pikën (c) të Udhëzimit 69, mund të evidentohen 2 lloje të paketave të hapura të të dhënave (përveç paketave me sasi pa limit interneti):

- i. paketa tarifore për të cilat sasia minimale e të dhënave e lejuar për roaming në Ballkanin Perëndimor e llogaritur për FUP, është më e madhe se sasia e të dhënave të përfshira në paketë për konsum brenda vendit;
- ii. paketa tarifore për të cilat sasia minimale e të dhënave e lejuar për roaming në Ballkanin Perëndimor e llogaritur për FUP, është më e vogël se sasia e të dhënave të përfshira në paketë për konsum brenda vendit.

83. Në rastin (i) kur sasia minimale e njësive të të dhënave të lejuar për roaming në Ballkanin Perëndimor (llogaritur në përputhje me nenin 4 (2), të Rregullores së FUP) është më e madhe se sasia e njësive të të dhënave të përfshira në paketë për konsum brenda vendit, pajtimtarët/klientët e roaming do të jenë në gjendje të konsumojnë internet në roaming në Ballkanin Perëndimor me RLAH (pa tarifim shtesë, pra sikundër të ishin në Shqipëri) të paktën sasinë e plotë të njësive të të dhënave (internetit) të përfshirë për konsum brenda vendit (në

Shqipëri). Pasi të tejkalohet ky kufi i lejuar për konsum brenda vendit, pajtimtari ose mund të blejë një paketë shtesë interneti (për të cilën aplikohet i njëjti parim si dhe paketat e zakonshme) ose pajtimtari do të tarifohet me tarifë standarde për njësi të internetit të aplikueshme në Shqipëri deri sa të arrihet sasia minimal/kufiri i lejuar i të dhënave për roaming në Ballkanin Perëndimor. Vetëm pasi të tejkalohet kufiri/limiti roaming, operatorët mund të aplikojnë një tarifë shtesë roaming mbi tarifën standarde për njësi të internetit, të aplikueshme në Shqipëri.

84.Në rastin (ii) kur sasia minimale e njërive të të dhënave të lejuara për roaming në Ballkanin Perëndimor (llogaritur në përputhje me nenin 4 (2), të Rregullores së FUP) është më e vogël se sasia e të dhënave të përfshira në paketë për konsum brenda vendit, pajtimtarët/klientët e roaming do të jenë në gjendje të konsumojnë internet në roaming në Ballkanin Perëndimor me RLAH (pa tarifim shtesë, pra sikundër të ishin në Shqipëri) të paktën sasinë e të dhënave (internetit) të lejuar për roaming në Ballkanin Perëndimor (në përputhje me Udhëzimin 55), pra, më pak se sasia e të dhënave (internetit) të përfshirë në paketë për konsum në Shqipëri. Pasi të jetë ezauruar sasia e të dhënave të lejuar për roaming në Ballkanin Perëndimor, operatori ka të drejtë të aplikojë një tarifë shtesë roaming mbi tarifën përkatëse të aplikueshme në Shqipëri.

6. Përdorimi aktual i të dhënave për roaming tejkalon kufirin e vëllimit të të dhënave në roaming që mund të blihet me kreditin e parapaguar të pajtimtarit.

85.Në rastin e referuar në pikën (d) të Udhëzimit 69, operatori celular ka të drejtë të aplikojë një tarifë shtesë roaming-u (mbi tarifën përkatëse të internetit në Shqipëri) për sasinë e të dhënave roaming që tejkalojnë kufirin e sasisë së të dhënave të lejuara për roaming në Ballkanin Perëndimor që mund të konsumohet me RLAH me kreditin e mbetur të parapaguar të pajtimtarit (të llogaritur në përputhje me nenin 4 (3), të Rregullores së FUP).

86.Për të ilustruar këtë rast, AKEP ka dhënë shembullin e mëposhtëm.

Shembull 11:

Një përdorues plani tarifor me parapagim (tarifa standarde PAYG) ka një kredit të mbetur prej 2000 ALL (pa TVSH) kur fillon të përdorë shërbimet e roaming të të dhënave në një vend të Ballkanit Perëndimor. Tarifa standarde me parapagim për përdorimin e internetit në Shqipëri nga pajtimtari është 500 ALL/GB (pa TVSH).

Me kreditin e mbetur në dispozicion, pajtimtari do të jetë në gjendje të konsumojë deri në **4 GB** të dhëna (internet) brenda vendit, pra në Shqipëri.

Për periudhën 1.7.2021 - 31.12.2021, tarifa maksimale me shumicë për të dhënat në roaming në Ballkanin Perëndimor është 7,885 Euro/GB (0.0077 euro/MB) apo 970 ALL/GB. **Me kreditin e mbetur prej 2000 ALL**, sasia e të dhënave e lejuar për roaming në Ballkanin Perëndimor e llogaritur në bazë të nenit 4 (3), të Rregullores së FUP për këtë pajtimtar do të ishte **2.06 GB**.

Në këtë rast, pajtimtari mund të konsumojë deri në 2.06 GB internet në roaming në Ballkanin Perëndimor me tarifën e aplikueshme në Shqipëri 500 ALL/GB. Nëse pajtimtari e konsumon të gjithë këtë sasi të lejuar për roaming në Ballkanin Perëndimor (me RLAH), llogaria e tij me parapagim do të debitohet me 1030 ALL për sasinë 2.06 GB ($2.06 \text{ GB} \times 500 \text{ ALL/GB} = 1030 \text{ ALL}$, pa TVSH).

Pas arritjes së limitit 2.06 GB në roaming, për çdo njësi shtesë të përdorimit nga pajtimtari të internetit në roaming në Ballkanin Perëndimor, operatori ka të drejtë të aplikojë tarifë shtesë (surcharge) roaming (tarifa shtesë roaming max. 970 ALL/GB, dhe tarifa max. totale roaming: $500+970=1470 \text{ ALL/GB}$).

VI. Tarifat alternative roaming

87. Në përputhje me pikat 9 dhe 10, të nenit 4, të Vendimeve të AKEP me nr. 22-24/2019, operatorët celularë kanë të drejtë të ofrojnë tarifa/paketa tarifore alternative, të cilat janë ato tarifa/paketa që ofrohen paralelisht me tarifat e rregulluara roaming me Ballkanin Perëndimor.

88. AKEP konsideron se operatorët celularë mund të ofrojnë paketa/oferta roaming kundrejt një tarife fikse periodike (p.sh., tarifat ditore apo paketa ditore javore etj.) gjatë periudhës tranzitore të RLAH+ (deri më 30.6.2021) sipas përcaktimeve të pikës 9, të nenit 4, të Vendimeve të AKEP me nr. 22-24/2019, dhe gjithashtu këto tarifa/paketa mund të ofrohen si tarifa alternative në vend të tarifave të rregulluar roaming me Ballkanin Perëndimor pas datës 1.7.2021 me hyrjen në fuqi të RLAH.

89. Sipas pikës 7 të nenit 4, të Rregullores së FUP, këto tarifa/plane tarifore alternative roaming mund të përfshijnë gjithashtu kushte kontraktuale për shërbimet e roaming që nuk përputhen me kriteret e FUP të përcaktuara në Rregulloren e AKEP.

90. Përcaktimet e Vendimeve të AKEP me nr.22-24/2019 dhe Rregullores së FUP krijojnë mundësinë për operatorët celularë që përveç tarifave të rregulluara roaming të ofrojnë tarifa/plane tarifore roaming të tjera (alternative) në Ballkanin Perëndimor, dhe çdo pajtimtar të ketë mundësinë që të zgjedhë me vullnet të lirë një tarifë roaming të ndryshme nga tarifat e rregulluara RLAH. Nëse pajtimtari vendos në mënyrë të qartë që të zgjedhë një tarifë alternative, ai duhet të informohet nga operatori (p.sh., me SMS, nëpërmjet faturës mujore, etj.) për mundësinë që ka për të konsumuar sipas RLAH dhe për natyrën e përparësive të RLAH, të cilat humbasin nëse ai zgjedh tarifën alternative. Tarifat alternative mund të jenë paketa shërbimesh roaming kundrejt një çmimi për njësi, tarifa fikse periodike të roaming, sasi njësisht shërbimesh roaming të përfshira në paketë që mund të përdoren dhe në vende të tjera përveç Ballkanit Perëndimor, etj.

91. Sipas paragrafit të fundit të pikës 10, të Vendimeve të AKEP me nr.22-24/2019, tarifat alternative roaming nuk mund të imponojnë kushte ose kufizime që kanë të bëjnë me elementet e pajtimit përveçse të roaming. Pra, tarifa alternative mund të ndikojë vetëm në kushtet e ofertës së shërbimit të roaming brenda dhe jashtë Ballkanit Perëndimor, dhe nuk duhet të

ndikojë në elementët e tjerë të paketës tarifore të pajtimtarit (p.sh., tarifa për shërbimet brenda vendit, oferta të tjera të përfshira në pajtimin mujor, si p.sh., subvencione të aparateve, njësi të shërbimit për t'u konsumuar në Shqipëri, etj.). Nëse "tarifa alternative" do të ndryshonte kushtet e tarifës/paketës tarifore brenda vendit, atëherë do të ndryshonin dhe kushtet përkatëse të tarifës së rregulluar RLAH dhe/ose FUP, dhe kjo nuk do të ishte në përputhje me pikë 10 të Vendimeve të AKEP me nr.22-24/2019.

92. Blerja nga pajtimtari e një pakete shtesë (*add-on*) për të qenë në gjendje që të konsumojë sasi shtesë shërbimesh (të dhënash) do të gjenerojë në mënyrë të ngjashme një kufi të ri minimal të përdorimit të drejtë (FUP) të shërbimit të rregulluar të të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor, duke iu nënshtuar rregullave për paketat e hapura të dhënave të aplikuara për këtë paketë shtesë (*add-on*). Por raste të tilla, nuk duhet të konsiderohen që pajtimtari ka zgjedhur një tarifë alternative roaming.

93. Sipas paragrafit të dytë të pikës 3, të nenit 5, të Vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, operatorët celularë do të dërgojnë në intervale të arsyeshme kohore një kujtesë pajtimtarëve që kanë zgjedhur një plan të ndryshëm tarifor nga tarifat e rregulluara të roaming-ut me Ballkanin Perëndimor. AKEP konsideron se, si interval të arsyeshëm kohor për këto njoftime/kujtesë, operatorët duhet të përdorin periudha jo më të gjata se 12 muaj. Gjithashtu, operatorët duhet ta përfshijnë këtë kujtesë edhe në momentet kohore të rinovimit ose ndryshimeve të kontratës të pajtimtarit që ka zgjedhur tarifë alternative roaming.

VII. Transferimi ndërmjet tarifave/planeve tarifore në roaming

94. Sipas përcaktimeve të pikës 4/10, të Vendimeve nr. 24-26/2019, operatorët celularë kanë detyrim që të aplikojnë automatikisht tarifat roaming sipas modelit RLAH për të gjithë klientët ekzistues dhe të rinj (që plotësojnë kushtet e vendbanimit dhe lidhjes së qëndrueshme me Shqipërinë sipas nenit 4 (1), të Rregullores së FUP). Siç është cituar në paragrafët e mësipërm dhe në Vendimet nr. 24-26/2019, operatorët celularë mund të ofrojnë tarifa alternative krahas tarifave RLAH, dhe pajtimtarët mund të zgjedhin shprehimisht të përdorin këto tarifa alternative në vend të tarifave RLAH. AKEP sqaron se, pas hyrjes në fuqi të RLAH më datë 1.7.2021, të gjithë pajtimtarët (ekzistues dhe të rinj) duhet që automatikisht të kalojnë në tarifat e rregulluara RLAH kur vizitojnë vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe përdorimi i tarifave alternative nga pajtimtarët që kanë zgjedhur më parë tarifat alternative është i lejuar vetëm kur pajtimtarët zgjedhin shprehimisht të qëndrojnë në këto tarifa alternative. Në rast të kundërt (pajtimtari nuk ka zgjedhur shprehimisht të vijojë të përdorë tarifat alternative roaming kur viziton vendet e Ballkanit Perëndimor), operatori do të aplikojë automatikisht tarifat e rregulluara roaming RLAH.

95. Sipas paragrafit të fundit të pikës 4/10, të Vendimeve nr.24-26/2019, çdo kalim nga një tarifë e rregulluar roaming RLAH në tarifë alternative roaming ose anasjelltas, duhet të kryhet pa pagesë, brenda një dite pune nga marrja e kërkesës dhe nuk duhet të sjellë kushte ose kufizime

që kanë të bëjnë me elementet e tjerë të paketës tarifore, përveçse ato të lidhur me roaming (për shembull, reduktim të sasisë së internetit për konsum në Shqipëri apo rritje të tarifës brenda vendit, një sasi njësisë të ulët të të dhënave të paketave të shtëpisë ose një çmim më i lartë i paketave të shtëpisë). Një operator celular mund të vonojë kalimin derisa tarifa e mëparshme e aplikuar për roaming ka qenë efektive për një periudhë minimale të specifikuar jo më shumë se dy muaj.

96. AKEP sqaron se me hyrjen në fuqi të RLAH në Ballkanin Perëndimor me datë 1.7.2021, klientët/pajtimtarët roaming mund të vendosin të qëndrojnë apo vazhdojnë me tarifën e tyre alternative roaming vetëm nëse operatori celular informon siç duhet këta pajtimtarë për opsionet në dispozicion të tyre dhe natyrën e përparësive të roaming në Ballkanin Perëndimor që do të humbin duke vijuar/duke kaluar me/në tarifën alternative në krahasim me kalimin/vijimin me tarifimin e rregulluar roaming të mundësuar nga RLAH. Ky informacion duhet t'i jepet pajtimtarit nga operatori celular p.sh., nëpërmjet SMS ose faturës mujore. Operatorët celularë duhet t'ua japin këtë informacion pajtimtarëve që përdorin tarifa alternative roaming kur vizitojnë Ballkanin Perëndimor në kohën e duhur, përpara hyrjes në fuqi të regjimit RLAH më 1.7.2021 (për shembull, dy javë para datës 1.7.2021), në mënyrë që këta pajtimtarë të kenë kohë të mjaftueshme që të marrin një vendim, të kryejnë një zgjedhje të informuar. AKEP sqaron se, për të qëndruar apo për të kaluar në një tarifë alternative roaming (në ndryshim nga tarifat RLAH) pas datës 1.7.2021, pajtimtarët duhet ta bëjnë këtë (dhe operatori ta aplikojë) vetëm pasi pajtimtarët të kenë zgjedhur shprehimisht opsionin e tarifës alternative në raport me atë të rregulluar RLAH. Siç është theksuar më lart, operatorët duhet të ofrojnë mundësinë pajtimtarëve në roaming në Ballkanin Perëndimor për të kaluar ndërmjet tarifave të rregulluara dhe alternative të roaming-ut në çdo moment të kohës, brenda një dite pune dhe falas.

97. Nëse operatorët bëjnë ndryshime në tarifat e tyre të roaming-ut për të cilat nuk kërkohet të respektojnë dispozitat e vendimeve nr.24-26/2019, pajtimtarët kanë të drejtë të tërhiqen nga kontrata e tyre në përputhje me përcaktimet e ligjit 9918/2008, legjislacionit kombëtar të aplikueshëm si dhe akteve përkatës rregullatorë të AKEP për mbrojtjen e konsumatorit dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

VIII. Transparenca dhe mekanizmi i kontrollit

98. Bazuar në pikën 4/11, të Vendimeve të AKEP nr. 22-24/2019, nenit 5, të Rregullores së FUP, si dhe sipas nenit 15, pika 1/j të Rregullores së Konsumatorit, të gjitha termat dhe kushtet që lidhen me një shërbim të rregulluar me pakicë roaming, përfshirë FUP, duhet të përfshihen në kontratat me pajtimtarët që përdorin shërbimet roaming. Kjo përfshin të gjitha termat dhe kushtet në lidhje me kërkesat për dhënien e provës së vendbanimit ose lidhjeve të qëndrueshme me Shqipërinë, në përputhje me nenin 4 (1), të Rregullores së FUP.

99. AKEP sqaron se, informacioni i specifikuar në pikën 4/11/a, të Vendimeve të AKEP me nr. 22-24/2019, duhet të përfshihet nga operatorët celularë në kontratat me pajtimtarët që përfshijnë shërbim të rregulluar me pakicë roaming, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke marrë detyrimet e Ligjit 9918/2018 si dhe të akteve nënligjore të AKEP për kontratat e pajtimit për shërbimet e komunikimit elektronik publik. Ky informacion duhet të jetë i personalizuar dhe të tregojë qartë çmimet me pakicë të shërbimeve të rregulluara roaming, të cilat aplikohen për një pajtimtar specifik dhe për të cilat konsumatori ka lidhur kontratën. Gjithashtu, në përputhje me pikën 4/11/b, të Vendimeve të AKEP me nr. 22-24/2019, ky informacion duhet të publikohet në faqen e internetit të operatorit celular. Përveç kësaj, operatorët celularë duhet të publikojnë në faqet e tyre të internetit dhe informacionin e përcaktuar në pikën 3, të nenit 1, të Rregullores së FUP në lidhje me tarifatat maksimale të aplikueshme për njësitë shtesë të shërbimeve roaming që tejkalojnë sasi të limit të përcaktuara sipas FUP.

100. Sipas pikës 4/11/ të vendimeve të AKEP me nr.22-24/2019, operatorët celularë duhet të përfshijnë në kontratat me pajtimtarët informacione rreth çdo kufizimi të aplikueshëm për sasi të dhënave që mund të përdoren në roaming në Ballkanin Perëndimor me tarifatat brenda vendit. Kjo duhet të sigurohet në një mënyrë të qartë dhe të aksesueshme. AKEP sqaron se operatorët mund të japin informacion mbi sasi të aktualë të dhënave të lejuara për roaming në Ballkanin Perëndimor me RLAH (pra pa tarifim shtesë) dhe në mënyra të tjera të thjeshta dhe të lehtësisht të aksesueshme nga pajtimtarët (p.sh., përmes aplikacioneve në celular, përmes zonës së klientit në faqen e internetit të operatorit), me kusht që operatori në aneksin e kontratës ku përfshihen tarifatat/plani tarifor i pajtimtarit, të specifikojë se si përcaktohet kufiri i lejuar i të dhënave në roaming në Ballkanin Perëndimor me RLAH. Kufiri i lejuar i të dhënave për roaming duhet të përditësohet sa herë që ndryshon tarifa e pajtimit dhe sa herë që ndryshon tarifa maksimale me shumicë e shërbimit të rregulluar të të dhënave (Sipas periudhave dhe niveleve përkatëse në vendimet e AKEP, nr.22-24/2019).

101. Në lidhje me informimin e pajtimtarëve të planeve tarifore me parapagim për kufizimin e sasisë së të dhënave që mund të përdorin në roaming në Ballkanin Perëndimor me tarifatat si në Shqipëri dhe me kreditin e mbetur (pika 3, e nenit 4, të Rregullores së FUP), AKEP sqaron se operatorët celularë duhet të përshkruajnë në mënyrë të qartë parimet kryesore për llogaritjen e këtyre sasive të lejuara të të dhënave për roaming në Ballkanin Perëndimor me RLAH duke përfshirë dhe ilustrime për vlera specifike të kreditit të mbetur (p.sh., sasi të dhënave që mund të përdoren në Ballkanin Perëndimor pa tarifë shtesë për 500 ALL apo 1000 ALL kredit që mund të ketë pajtimtari kur fillon të përdorë roaming data në Ballkanin Perëndimor).

102. Në përputhje me pikën 1, të nenit 5, të Rregullores së FUP, kriteret që aplikohen nga një operator celular si tregues objektivë për të parandaluar rrezikun e përdorimit abuziv ose anormal të shërbimeve roaming të rregulluara në Ballkanin Perëndimor (në përputhje me nenin 4 (4), të Rregullores së FUP) duhet të përcaktohen paraprakisht në kontratën që përfshin FUP-in. Kontrata duhet të përfshijë:

- një përshkrim të kriterëve objektivë të përdorur, domethënë arsyet mbi të cilat operatori mund bazohet për të dërguar një njoftim paralajmërues dhe aplikuar një tarifë shtesë roaming (*surcharge*) në përputhje me nenin 5 (3) dhe 5 (4), të Rregullores së FUP, duke përfshirë:
 - përkufizimin dhe kohëzgjatjen e periudhës së monitorimit;
 - informacion se si llogariten konsumi dhe prania/prezenca me qëllim të aplikimit të ndonjë tarife shtesë roaming (përfshirë shërbimin/shërbimet celulare me pakicë që janë të lidhur me treguesin e konsumit, sipas nënparagrafit të katërt të nenit 4 (4), të Rregullores së FUP);
 - fakti që operatori celular mund të dërgojë një mesazh paralajmërues pas periudhës së vëzhgimit, dhe mundësinë e pajtimtarit të ndryshojë modelin e përdorimit të tij brenda një periudhe paralajmëruese, duke demonstruar prevalimin e konsumit apo pranisë në Shqipëri për të shmangur aplikimin e tarifës shtesë roaming (në përputhje me nenin 5 (4), të Rregullores së FUP);
- një përshkrim të procedurës që pajtimtari duhet të ndjekë për të paraqitur pretendimet, siç parashikohet në nenin 5 (1), të Rregullores së FUP;
- një përshkrim të kriterëve për ndërprerje e aplikimit të tarifave shtesë roaming (në përputhje me nenin 5 (5), të Rregullores së FUP).

103. Në përputhje me pikën 1, të nenit 5, të Rregullores së FUP operatori celular ka detyrime të krijojë procedura transparente, të thjeshta dhe efikase për të adresuar ankesat e pajtimtarëve në lidhje me aplikimin e FUP. Pajtimtari duhet të jetë në gjendje të kontaktojë shpejt dhe me lehtësi operatorin celular, veçanërisht kur operatori ka dërguar njoftim paralajmërues, si dhe më pas, kur shërbimet e roaming të përdorura nga pajtimtari janë duke u tarifuar me tarifa shtesë roaming. AKEP sqaron se, operatorët celularë duhet të sigurojnë/ofrojnë ndërfaqe alternative për këto lloje ankesash të pajtimtarëve të tilla si online chats, call centers, e-mail etj. Ndërfaqe të tilla duhet ta bëjnë të thjeshtë dhënien e provave nga pajtimtarët që njoftimi paralajmërues nuk bazohet në informacion të saktë ose të plotë, dhe që ata të ofrojnë prova se nuk janë duke përdorur shërbimet roaming në Ballkanin Perëndimor për qëllime të ndryshme nga ato të udhëtimit periodik.

104. Në përputhje me pikën 2, të nenit 5, të Rregullores së FUP, operatorët celularë duhet të njoftojnë AKEP për çdo FUP që ata mund të aplikojnë për shërbimet e rregulluara të roamingut në Ballkanin perëndimor, të paktën 15 ditë përpara publikimit të tyre, dhe jo më vonë se 15 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre. Operatori celular duhet t'i dërgojë AKEP informacione të plota mbi FUP përpara se të implementohet apo të hyjë në fuqi çdo FUP.

105. Nëse një operator zbulon që kartat e tij SIM janë pjesë e rishitjes së organizuar për përdoruesit që nuk kualifikohen për RLAH, ai mund të ndërmarrë veprime të menjëhershme sipas nenit 4 (5), të Rregullores së FUP dhe Kapitullit IV të këtyre Udhëzimeve. Operatori celular duhet të raportojë në AKEP çdo masë të ndërmarrë për këtë qëllim, duke përfshirë edhe një përshkrim të llojit të provës që operatori ka për abuzimin sistematik në fjalë. Sipas pikës 6,

të nenit 5, të Rregullores së FUP, këto njoftime do të dërgohen në AKEP jo më vonë se koha e marrjes së masave të tilla.

1. Informacion bazë i personalizuar tarifor për thirrjet, SMS dhe të dhëna

106. Në përputhje me pikat 5 dhe 6, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, të gjithë klientët (përveç atyre që kanë zgjedhur të mos marrin këtë shërbim) kur hyjnë në një vend të Ballkanit Perëndimor kanë të drejtë të marrin një mesazh automatik me informacion për roaming-un. Mesazhi automatik, duke përfshirë informacionin bazë të roaming, duhet të jetë i personalizuar për atë pajtimtar, dhe ky informacion i personalizuar duhet t'u dërgohet edhe klientëve me tarifa alternative roaming.

107. AKEP sqaron se, edhe nëse operatori nuk aplikon një tarifë shtesë roaming, pajtimtarët duhet të marrin një mesazh automatik të personalizuar, i cili përmban informacionin për kushtet e aplikuara për përdorimin e shërbimeve me pakicë të roaming nga klienti/pajtimtari specifik. Operatori celular duhet të dërgojë informacion në momentin kur pajtimtari hyn për të vizituar vendin e Ballkanit Perëndimor. Për roaming të të dhënave, informacioni duhet të dërgohet në pajisjen celulare të pajtimtarit, pavarësisht nga lloji i pajisjes (telefon celular tradicional, smartphone, tablet ose laptop me USB/dongle). Për këtë shërbim, mjetet e dërgimit të informacionit mund të jenë, për shembull, përmes mesazhit SMS, e-mail ose një dritareje pop-up. Informacioni për roaming-un e të dhënave do të përcillet në pajisjen celulare të pajtimtarit në roaming, sa herë që ai/ajo hyn në një vend të Ballkanit Perëndimor, dhe kur pajtimtari fillon për herë të parë një sesion shërbimi të të dhënave për roaming në atë vend të veçantë. (shiko Udhëzimin 115). Sipas pikës 15/2, të vendimeve 22-24/2019 të AKEP, informacioni duhet të jepet "me një mjet të përshtatshëm për të lehtësuar marrjen dhe kuptimin e lehtë të tij" dhe AKEP konsideron se është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje që një informacion i tillë duhet të dërgohet "në atë mënyrë që të mundësojë akses të lehtë në këtë informacion edhe në një moment të mëvonshëm". Informacioni duhet të ofrohet në atë mënyrë që të mos i imponojë pajtimtarit të përdorë një shërbim roaming të të dhënave për të marrë apo aksesuar atë. Kjo mund të menaxhohet nëpërmjet një SMS-je ose një linku në një faqe interneti pa pagesë ose në ndonjë mjet tjetër të ngjashëm. Informacioni i mësipërm do t'u dërgohet në roaming klientëve edhe kur udhëtojnë jashtë Ballkanit Perëndimor.

108. Klientëve në roaming duhet t'u ofrohet informacioni bazë i mëposhtëm:

- fakti që kur janë në roaming në një vend të Ballkanit Perëndimor aplikohen tarifa sikundër të ishin në Shqipëri (nëse është e nevojshme, edhe informacioni që e bën pajtimtarin të vetëdijshëm se thirrjet dhe SMS do të tarifohen me tarifa off-net) ose çmimet e zbatueshme të roaming që aplikohen kur janë në roaming në një vend jashtë Ballkanit Perëndimor;
- informacion mbi FUP që është i aplikueshëm ndaj pajtimtarit në roaming dhe çdo tarifë shtesë roaming që aplikohet për sasitë e konsumuara përtej limiteve të FUP (vetëm brenda Ballkanit Perëndimor, tarifatat në ALL me TVSH);

- një numër pa pagesë nga i cili pajtimtari, përmes një thirrje zanore ose një mesazhi SMS, mund të marrë informacion më të detajuar të personalizuar për shërbimet e thirrjeve zanore, mesazheve SMS, ose të të dhënave (përfshirë MMS) roaming të rregulluara dhe të parregulluara, informacion mbi aplikimin e FUP dhe çdo tarifë shtesë, si dhe informacion mbi masat e transparencës sipas vendimeve nr.22-24/2019 të AKEP;
- mundësinë e aksesit në shërbimet e emergjencës duke telefonuar pa pagesë numrin unik european të emergjencave 112 (vetëm në roaming në BP apo BE).

109. Lidhur me FUP, operatorët duhet të japin informacion në lidhje me sasinë e të dhënave të përfshira në roaming në Ballkanin Perëndimor me RLAH (pa tarifim shtesë) nëse pajtimtari/klienti është objekt i një kufiri të tillë (në rastin e paketave të hapura të të dhënave dhe planeve tarifore me parapagim duke përfshirë edhe sasinë specifike të të dhënave të përfshira për roaming në Ballkanin Perëndimor të shprehura në MB ose GB). Për planet tarifore me parapagim (PAYG), sasia absolute e njërive të të dhënave të përfshira/lejuara për roaming në Ballkanin Perëndimor me RLAH ndikohet nga konsumi i thirrjeve dhe SMS-ve, kështu që në këto raste mund të jepet informacion më i përgjithshëm që shpjegon se kufiri i zbatueshëm i përdorimit të drejtë të të dhënave është në varësi të konsumit dhe të shërbimeve të tjera dhe të vendoset një link ku pajtimtari mund të gjejë informacion më të detajuar. Informacioni shtesë mbi mekanizmat e kontrollit etj., mund të ofrohet përmes një linku që të drejton në faqe të aksesueshme pa pagesë ose në një faqe në internet.

110. AKEP rekomandon që operatorët të përfshijnë informacion shtesë, siç janë tarifat brenda vendit, të cilat aplikohen për klientin/pajtimtarin specifik, sipas planit tarifor ekzistues të tij, dhe nëse marrja e mesazheve të postës zanore (*voicemail*) në roaming jashtë Ballkanit Perëndimor është me pagesë (dhe vlera e tarifës) si dhe intervalet e tarifimit nëse ato janë të ndryshme kur është në roaming në Ballkanin Perëndimor.

111. Pajtimtarët kanë mundësinë të zgjedhin që të mos marrin informacionin mbi tarifat për shërbimet e rregulluara të roamingut në Ballkanin Perëndimor, si dhe të drejtën, në çdo kohë dhe falas, të kërkojnë nga operatori celular të ofrojë përsëri informacionin. AKEP sqaron se, operatorët celularë do të vazhdojnë të ofrojnë informacionin e nevojshëm për pajtimtarët kur ata janë në roaming jashtë Ballkanit Perëndimor.

Kur duhet të ofrohet informacioni bazë?

112. Operatorët duhet që t'i dërgojnë pajtimtarit informacionin bazë të personalizuar për tarifat "pa vonesa të panevojshme dhe pa pagesë" kur ato lidhen për herë të parë në një rrjet tjetër, të ndryshëm nga ai i operatorit të tyre të Shqipërisë, kur udhëtojnë jashtë vendit ose çdo kohë kur një klient/pajtimtar kalon kufirin e një vendi jashtë Ballkanit Perëndimor.

113. Kjo siguron që klientët/pajtimtarët të informohen për tarifat e roaming para se të përdorin shërbimet roaming. Kur pajtimtari vazhdon të udhëtojë në një vend tjetër brenda Ballkanit Perëndimor, nuk është e nevojshme që operatori të dërgojë përsëri informacion bazë tarifor.

Operatorët duhet të japin informacion të plotë mbi tarifat e aplikueshme të roaming-ut për thirrjet dhe SMS-të për të gjithë klientët në roaming në kohën e lidhjes së kontratës së pajtimit.

114. Në përputhje me pikën 5/3, të vendimeve nr.22-24/2019 të AKEP, operatorët celularë duhet t'u sigurojnë klientëve/pajtimtarëve të tyre në roaming përditësime mbi tarifat ose çmimet e aplikueshme të roaming-ut pa vonesa të panevojshme, sa herë që ka një ndryshim të tyre. Kjo do të thotë që informacioni i plotë për tarifat e aplikueshme duhet të ofrohet para fillimit të zbatimit të një kontrate dhe çdo herë që një operator celular kryen ndryshime në tarifat e tij me pakicë të roaming, përfshirë edhe kur kërkohet nga ligji 9918/20018 dhe aktet nënligjore përkatëse të AKEP.

115. Përveç sa më sipër, në përputhje me pikën 6/2, të vendimeve nr.22-24/2019 të AKEP, operatorët celularë duhet që informacionin mbi roaming-un e të dhënave, i cili përfshin MMS, duhet të jepet sa herë që klienti roaming lidhet me një rrjet të vizituar dhe inicion për herë të parë një shërbim roaming të të dhënave në atë të vend të vizituar, d.m.th., kur klienti vazhdon të udhëtojë nga një vend i vizituar në një tjetër, një informacion mbi tarifat kërkohet t'i dërgohet përsëri pajtimtarit, përveç rasteve kur tarifat e aplikueshme janë të njëjta. AKEP sqaron se kjo dispozitë kërkon vetëm njoftimin e klientit një herë kur pajtimtari hyn në një vend tjetër të vizituar. Operatorët nuk duhet të tarifojnë klientin/pajtimtarin në roaming për ndonjë shërbim të rregulluar të roaming të të dhënave, përpara se klienti/pajtimtari në roaming të pranojë ofrimin e shërbimit.

116. Për përdoruesit e laptopëve me dongle/usb ose pajisje të ngjashme, lidhja me rrjetin e vizituar dhe fillimi i sesionit të roaming të të dhënave janë të njëkohshëm. Rrjeti i MNO të Shqipërisë është në gjendje të tregojë se përdoruesi është lidhur me një rrjet të vizituar, vetëm kur ai fillon një sesion roaming të të dhënave. Prandaj, MNO duhet të dërgojë një mesazh për të ofruar të gjithë informacionin e nevojshëm. Kjo, për shembull, mund të ofrohet falas në një faqe interneti *offline* (duke shfaqur informacionin e tarifave) që hapet kur fillohet një seancë për roaming të të dhënave, si dhe para se të kryhet ndonjë transferim i të dhënave (që është objekt tarifimi/pagese ose FUP).

117. Lidhja me rrjetin e vizituar dhe fillimi i një sesioni roaming të të dhënave nuk janë domosdoshmërisht të njëkohshëm pasi klientët/pajtimtarët mund të përdorin shërbime të thirrjeve dhe SMS-ve, por fillojnë përdorimin e të dhënave në roaming në një moment tjetër të mëvonshme, ose nuk lidhen apo përdorin fare këtë shërbim (p.sh., *data roaming off*). Në të gjitha rastet, operatori duhet të informojë klientët/pajtimtarët menjëherë sapo aparatet e tyre lidhen me një rrjet të vizituar, dhe më pas, menjëherë sapo inicojnë për herë të parë një sesion të roaming-ut të të dhënave.

118. MNO nuk ka detyrim që të dërgojë mesazhe të tjera, gjatë një vizite në Ballkanin Perëndimor, nëse ndryshon rrjeti i vizituar, por që është në të njëjtin vend të Ballkanit Perëndimor.

119. Kur klienti kontakton MNO e Shqipërisë për të kërkuar informacione shtesë më të detajuara, MNO duhet të sigurojë që informacioni mbi çmimet e thirrjeve dhe SMS në roaming (sipas pikës 5/2, të vendimeve nr.22-24/2019 të AKEP) i vihet menjëherë në dispozicion atij

klienti, pavarësisht nga koha e ditës. Nëse për të përmbushur këtë detyrim MNO-të përdorin makina të automatizuara, MNO duhet të sigurojë që klienti të mund të përdorë me shpejtësi dhe lehtësi informacionin e personalizuar të kërkuar. Gjithashtu, çdo kontakt/komunikim i tillë nga një klient/pajtimtar me MNO-në e tij, duhet të jetë pa pagesë.

120. Përveç sa më sipër, nëse kontaktimi kryhet me SMS, dhe kur informacioni për tarifën është kompleks, do të ishte e arsyeshme që MNO t'i dërgojë pajtimtarëve të tij vetëm informacion thelbësor të personalizuar të tarifave, të aplikueshme për shërbimet roaming të thirrjeve zanore, SMS dhe të të dhënave (përfshirë MMS). Në këtë rast, MNO duhet të përfshijë një referencë në mesazhin e tij SMS për numrin pa pagesë të caktuar për thirrjet zanore ku pajtimtari mund të marrë informacion shtesë. Gjithashtu, mund të ofrohet dhe alternativa për akses pa pagesë në një faqe interneti offline.

121. Pajtimtarët duhet të jenë në gjendje të monitorojnë, kontrollojnë dhe japin pëlqimin e tyre për çdo shpenzim. Në lidhje me roaming-un e të dhënave, sipas pikës 6/1 të vendimeve nr.22-24/2019 të AKEP, MNO-të duhet të sigurojnë që klientët e tyre në roaming të jenë të informuar në mënyrë vazhdueshme për tarifën e roaming të të dhënave si para, ashtu edhe pas lidhjes së një kontrate, në mënyra që të lehtësojnë të kuptuarit e klientëve për pasojat financiare të përdorimit të tyre dhe t'u mundësojnë atyre të monitorojnë dhe kontrollojnë shpenzimet në shërbimet e rregulluara të roaming të të dhënave. AKEP konsideron se interval i arsyeshëm kohor do të ishte çdo 12 muaj, ose ndonjë periudhë tjetër më e shkurtër që lidhet me rinovimin ose rishikimin/ndryshimin e kontratës. Vendimet nr.22-24/2019 të AKEP parashikojnë gjithashtu që, kur është e përshtatshme, MNO-të do të informojnë klientët e tyre përpara lidhjes së një kontrate, dhe rregullisht pas kësaj, për rrezikun e lidhjeve dhe shkarkimeve të automatizuara dhe të pakontrolluara në roaming. MNO-të gjithashtu duhet të shpjegojnë, pa pagesë dhe në një mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme, se si pajtimtarët të çaktivizojnë roaming-un automatik të të dhënave për të shmangur konsumin e pakontrolluar të të dhënave në roaming. MNO-të mund t'i plotësojnë këto kërkesa duke siguruar informacion të qartë dhe lehtësisht të aksesueshëm në termat dhe kushtet e tyre për shërbimin celular në faqen e tyre të internetit.

2. Njoftimi për konsumin brenda një FUP në lidhje me kufijtë sasiore të të dhënave

122. Në përputhje me pikën 6/2, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, MNO do t'i dërgojë një njoftim klientit në roaming, kur kufiri i aplikueshëm i përdorimit të drejtë të shërbimit të të dhënave në roaming të konsumohet plotësisht ose të arrihet ndonjë prag përdorimi që zbatohet në përputhje me pikën 4/7, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP dhe Rregullores së FUP. Njoftimi duhet të përmbajë tarifën shtesë roaming që do të aplikohet për çdo konsum shtesë të shërbimeve të rregulluara të roaming të të dhënave nga klienti/pajtimtari. Çdo pajtimtar duhet të ketë të drejtë të kërkojë nga MNO të ndalojë dërgimin e njoftimeve të tilla si dhe do të ketë të drejtën, që në çdo kohë dhe falas, të kërkojë nga MNO të ofrojë përsëri shërbimin e njoftimit.

3. Paralajmërimi i pajtimtarit për aplikimin e një tarife shtesë të mundshme, bazuar në tregues objektivë

123. MNO do të paralajmërojë pajtimtarin përpara se të aplikojë ndonjë tarifë shtesë mbi bazën e treguesve objektivë të përcaktuar në nenin 4/ dhe 4/5, të Rregullores së FUP. MNO duhet të informojë klientin për një periudhë paralajmëruese jo më të shkurtër se dy javë, dhe në mungesë të një ndryshimi në modelin e përdorimit brenda asaj periudhe paralajmëruese, MNO mund të aplikojë një tarifë shtesë për çdo përdorim të shtesë pas datës së njoftimit paralajmërues. Në njoftimin e paralajmërimit MNO duhet të specifikojë edhe tarifën shtesë roaming të aplikueshme. Nëse modeli i përdorimit nuk ndryshon brenda periudhës së paralajmërimit, MNO mund të aplikojë një tarifë shtesë roaming për çdo përdorim të mëtejshëm, gjatë dhe pas periudhës së paralajmërimit, duke filluar prej datës së njoftimit të paralajmërimit, në përputhje me kushtet e FUP në fuqi dhe pajtimtari duhet të jetë i informuar kur fillon aplikimi i tarifës shtesë. AKEP rekomandon që MNO të mos e faturojë tarifimin shtesë (në rast se periudha e faturimit përfundon gjatë periudhës së paralajmërimit) derisa të përfundojë periudha e paralajmërimit dhe nuk është vërejtur ndonjë ndryshim relevant në modelin e përdorimit nga pajtimtari. Në këtë mënyrë MNO nuk do të ketë nevojë që të rimbursojë tarifat e faturuara tashmë në rast se modeli i përdorimit të klientit ka ndryshuar pasi të jetë dërguar fatura, ose në rast se mosmarrëveshja ndërmjet operatorit dhe klientit është zgjidhur në favor të këtij të fundit.

124. Pas dërgimit të njoftimit të paralajmërimit nga MNO, klienti roaming mund të kërkojë të sqarojë ose kontestojë konkluzionin e MNO-së se ekziston rreziku i përdorimit abuziv ose anormal i shërbimeve të roaming përtej udhëtimit periodik, në përputhje me procedurat e trajtimit të ankesave në lidhje me zbatimin e FUP të MNO, sipas pikës 1, të nenit 5, të Rregullores së FUP, dhe procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve pajtimtar-operator sipas ligjit 9918/2008 dhe akteve nënligjore të AKEP. Këto mekanizma të trajtimit të ankesave dhe procedurave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve do t'i lejojnë klientit roaming, që në përgjigje të njoftimit të paralajmërimit të MNO-së, të sigurojë prova se ata nuk janë duke përdorur shërbimet e rregulluara me pakicë të roaming në Ballkanin Perëndimor për qëllime të ndryshme nga udhëtimi periodik.

125. Në përputhje me nënparagrafin e dytë, të nenit 5/3, të Rregullores së FUP, kur rreziku i përdorimit abuziv ose anormal, rezulton nga mospërbushja e të dy kritereve të mbizotërimit të konsumit të shërbimeve celulare si dhe të pranisë në Shqipëri gjatë së paku katër muajve të dritares së vëzhgimit, në zgjidhjen e kësaj ankese ose mosmarrëveshje duhet të merren parasysh indikacione shtesë të rrezikut, që vijnë nga prezenca apo përdorimi i përgjithshëm i shërbimeve jashtë Shqipërisë të pajtimtarit. Për shembull, në raste kur prezenca dhe përdorimi i shërbimeve jashtë Shqipërisë i pajtimtarit është vetëm pak më shumë se 50% gjatë periudhës së dritares së vëzhgimit (periudhës së monitorimit), dhe pajtimtari siguron prova thelbësore që mbulojnë një periudhë më të gjatë kohore se katër muaj, përfshirë për një periudhë të ardhmen, për vendbanimin në Shqipëri ose lidhje të qëndrueshme me Shqipërinë, mund të vlerësohen

ndryshe me rastet kur pajtimtari ka shpenzuar pjesën më të madhe të periudhës së dritares së vëzhgimit jashtë Shqipërisë dhe paraqet pak ose aspak prova shtesë.

126. Në përputhje me Kapitullin 4 (Udhëzimi 35) dhe Kapitullin V të këtyre udhëzimeve, tarifa shtesë roaming mund të aplikohet për shërbimin/shërbimet me pakicë në roaming, për të cilin/cilat është zbuluar rreziku i përdorimit abuziv ose anormal.

127. AKEP sqaron se periudha minimale e paralajmërimit prej dy javësh vlen gjithashtu kur paralajmërimi bazohet në treguesit e tjerë objektivë të diskutuar në Udhëzimet 36 deri 39.

128. AKEP konsideron se ndryshimi i kërkuar në modelin e përdorimit brenda periudhës së paralajmërimit për të shmangur aplikimin nga MNO të tarifave shtesë roaming, duhet të adresojë rrezikun e vërejtur të përdorimit abuziv ose anomal, në bazë të të cilit konsumatori është paralajmëruar. AKEP vlerëson se nëse pajtimtari përmbush kriterin e mbizotërimit të konsumit të shërbimeve në Shqipëri ose të mbizotërimit të pranisë në Shqipëri gjatë periudhës dy javore të paralajmërimit, atëherë kjo duhet të konsiderohet si ndryshim i modelit të përdorimit nga pajtimtari.

129. Sipas nenit 5/5, të Rregullores së FUP, MNO do të ndërpresë aplikimin e tarifës shtesë roaming për shkak të rrezikut të përdorimit abuziv ose anormal menjëherë sapo përdorimi i klientit nuk tregon më një rrezik bazuar në treguesit objektivë të përmendur në nenin 4/4, të Rregullores së FUP. MNO duhet të ndërpresë së aplikuari tarifën shtesë roaming sa më shpejt që të plotësohet njëri prej kriterëve të mbizotërimit (pranisë ose konsumit në Shqipëri). Për të vendosur një ndryshim të tillë në modelin e përdorimit dhe që operatori të jetë i sigurt se ekziston një tregues i qartë se nuk ekziston rreziku i përdorimit abuziv ose anormal, pas periudhës së paralajmërimit, operatori duhet të vazhdojë të monitorojë konsumin dhe prezencën e klientit në të njëjtën mënyrë siç bëri deri para paralajmërimit.

4. Kufiri financiar ose sasi i konsumit të të dhënave roaming

130. Sipas pikës 6/3, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, MNO-të kanë detyrim që të vendosin në dispozicion të pajtimtarëve të tyre një ose më shumë kufij maksimalë financiar ose vëllimi (sasi) për përdorimin e të dhënave në roaming gjatë një periudhe të caktuar të dakordësuar, në varësi të dhënies së pëlqimit nga pajtimtari për të vazhduar ("mekanizmi i ndërprerjes/cut-off mechanism"). Qëllimi i këtij përcaktimi të vendimeve të cituara të AKEP është që MNO-të të mundësojnë pajtimtarët e tyre të shmangin kryerjen e shpenzimeve dhe faturave që janë shumë më të larta se nivelet e pritshme të tyre kur përdorin shërbimet roaming të të dhënave. Në vendimet nr. 22-24/2019 të AKEP përdoret termi 'Klient', i cili mund të interpretohet si palë kontraktuese që mund të ketë disa përdorues (p.sh., kontrata me pajtimtarë të kategorisë Biznes apo Familjarë që mund të ketë disa numra celularë/karta SIM në të njëjtin subjekt), ose edhe si përdoruesi individual i kartës SIM. MNO-të, në rastet e kontratave të kategorisë Biznes, duhet të sqarojnë se ndaj kujt aplikohet kufiri i financiar apo sasi si dhe mekanizmi i Cut Off. Megjithatë, AKEP rekomandon që MNO-të të përdorin kufirin financiar dhe mekanizmin Cut Off bazuar në kartat SIM, pra për çdo përdorues individual/kartë SIM.

131. Implementimi i RLAH nga datat 1.7.2021 do të minimizojë rrezikun e faturave/shpenzimeve tepër të larta (*bill shock*) për shumicën e pajtimtarëve që përdorin roaming në Ballkanin Perëndimor. Pajtimtarët të cilët përdorin oferta me parapagim për vlera fikse monetare dhe jo-periodike, për të cilat ndërpritet automatikisht përdorimi i internetit pasi ka mbaruar sasia e përfshirë në ofertë apo vlefshmëria e ofertës, dhe përdorimi i internetit rifillon vetëm pasi pajtimtari të ketë dhënë pëlqimin e shprehur për vazhdimin e tij, janë automatikisht të mbrojtur nga faturat/shpenzimet tepër të larta si në Shqipëri, ashtu edhe në roaming. Këta klientë janë të mbrojtur automatikisht nga “*bill shock*” dhe nuk është e nevojshme që të ketë rregullime specifike, pasi këta pajtimtarë nuk janë në gjendje të shpenzojnë më shumë se ata kanë rënë dakord përpara fillimit të përdorimit të të dhënave (brenda vendit dhe në roaming), pra duke u dhënë atyre kontroll mbi shpenzimet.

Megjithatë, ky përjashtim (nga aplikimi i limitit financiar) nuk zbatohet për planet tarifore të të dhënave të cilat janë pjesërisht fikse dhe pjesërisht të ndryshueshme (tarifim në bazë të sasisë së konsumuar) ose që përsëriten automatikisht në lidhje me çmimin dhe/ose kohëzgjatjen, për shembull, një plan tarifor me vlerë monetare dhe/ose volum fikse për një periudhë fillestare dhe më pas një tarifim variabël për njësi (në bazë të sasisë së konsumuar), ose aplikimi i një tarife ditore që përsëritet derisa klientët të tërheqin pëlqimin e tyre. P.sh., ofertat roaming (ditore, javore etj.) që kanë të përfshirë një sasi të caktuar të dhënash roaming kundrejt një vlerë monetare fikse (me paspagim apo parapagim), dhe pas përdorimit të kësaj sasive aksesit në internet nuk ndërpritet dhe pajtimtari tarifohet për njësitë shtesë të përdorura të internetit (megjithëse mund të ketë marrë një mesazh informues nga operatori për këtë), nuk plotësojnë kushtin e kontrollit të shpenzimeve dhe operatori duhet të aplikojë limitin financiar (5000 ALL/muaj pa TVSH) dhe mekanizmin Cut Off të shpjeguar në vendimet e AKEP me nr. 22-24/2019.

132. AKEP sqaron se MNO-të duhet të aplikojnë limitin financiar dhe mekanizmin e Cut Off në rastet e mëposhtme:

- përdorimi i tarifave për njësi roaming me parapagim dhe paspagim në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe jashtë Ballkanit Perëndimor (pika 6/6, e vendimit nr. 22-24/2019 të AKEP);
- në rastet kur aplikohet një tarifë shtesë roaming (*surcharge*) sipas Kapitullit 5 të këtyre udhëzimeve.

Pra, aplikimi dhe llogaritja e konsumit për limitin financiar ose sasi të të dhënave në roaming, kryhet për tarifimin për njësi të internetit, për konsum jashtë paketave dhe për rastet e tarifave shtesë të roaming-ut për njësi (MB apo GB).

133. Bazuar në përcaktimet e akteve nënligjore të AKEP, MNO-të kanë detyrim të njoftojnë pajtimtarët kur arrihet niveli 80% dhe 100% i konsumit të internetit në paketat tarifore brenda vendit dhe në roaming. Ky njoftim gjithashtu duhet t'i jepet pajtimtarit kur të arrijë kufirin e paracaktuar (*default*) në roaming.

134. MNO-të duhet të aplikojnë automatikisht kufirin e paracaktuar (*default*) financiar ose kufirin e parazgjedhur të vëllimit për të gjithë klientët që nuk kanë zgjedhur tashmë një kufi të ndryshëm specifik. MNO-të duhet të shpjegojnë në faqen e tyre të internetit dhe kontratat me pajtimtarët, se si funksion mekanizmi i ndërprerjes (*Cut-off*) kur arrihet limiti i paracaktuar/zgjedhur, përfshirë mënyrën se si pajtimtarët të japin dakordësinë e tyre që të përdorin internetit përtej kufirit të zgjedhur nëse e dëshirojnë këtë, dhe çfarë do të ndodhë me të dhënat gjatë shkarkimit kur arrihet limiti nëse klienti nuk dëshiron të vazhdojë përdorimin e internetit përtej limit. MNO-të duhet të ofrojnë informacion mbi konsumin në mënyrë periodike për pajtimtarët që kanë zgjedhur shprehimisht që të mos kenë kufi të ndërprerjes (limit financiar dhe mekanizëm *cut-off*), me qëllim që të parandalojnë shpenzimet apo faturat tepër të larta.

135. Sipas pikës 6/3, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, kufiri financiar i parazgjedhur duhet të jetë jo më shumë se 5000 ALL, pa TVSH, për çdo periudhë mujore faturimi. Kufiri sasiar/vëllimit i parazgjedhur duhet të ketë një kufi financiar ekuivalent që nuk tejkalon 5000 ALL/muaj pa TVSH, dhe ky kufi duhet të rifreskohet automatikisht çdo periudhë faturimi. AKEP sqaron se limiti financiar mujor ka të bëjë me shpenzimet e akumuluar për një periudhë mujore faturimi, dhe jo për një sesion të veçantë të përdorimit të të dhënave në roaming.

136. Limit financiar prej 5000 ALL ose çdo limit tjetër financiar i referuar shpenzimeve jashtë paketës duhet të llogaritet akumulativisht nga MNO në rast se pajtimtari udhëton disa herë brenda së njëjtës periudhë dhe/ose në vende të ndryshme, brenda dhe jashtë Ballkanit Perëndimor. Limiti financiar aplikohet si për përdoruesit me paspagim, ashtu edhe për ata me parapagim. Megjithëse përdoruesit me parapagim kanë kontroll mbi shpenzimet e tyre, brenda vendit dhe në roaming, ka raste që dhe këta përdorues mund të jenë objekt i “*bill shock*”, për shkak se tarifat e internetit në roaming janë relativisht të larta dhe mund të shkaktojnë harxhim shumë të shpejtë të krediteve të parapaguara. MNO-të duhet të aplikojnë automatikisht limitin financiar 5000 ALL/muaj pa TVSH dhe mekanizmin *Cut-off* për konsum të internetit në roaming (BP dhe vende të tjera) dhe për pajtimtarët me parapagim, sidomos ata që kanë kredite mbi këtë limit.

137. Përveç limit 5000 ALL/muaj pa TVSH, MNO-të mund të vënë në dispozicion një ose më shumë kufij të tjerë financiar ose të vëllimit, më të lartë ose më të ulët, për periudha të tjera të specifikuara të përdorimit (d.m.th., jo domosdoshmërisht për muaj, për shembull, mund të ofrohet një kufi ditor ose javor); përsëri me kusht që klienti të ndërjegjësohet paraprakisht për vëllimin përkatës ose shumën financiare. Në çdo rast, MNO ka detyrim që të shoqërojë kufirin financiar apo sasiar me mekanizimin *Cut-off*, dhe të vijojë me ofrimin e internetit në roaming vetëm pasi ka marrë pëlqimin e shprehur nga pajtimtari.

138. Sipas pikës 6/3, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, në rastet kur aplikohet kufi financiar ose i vëllimit për internetin në roaming, MNO-të duhet t'i dërgojnë pajtimtarit një paralajmërim kur ata kanë konsumuar 80% të kufirit financiar ose sasiar përkatës. Qëllimi i përgjithshëm i politikës së limitit financiar është të bëjë të mundur që pajtimtarët të monitorojnë dhe kontrollojnë shpenzimet e tyre në roaming. MNO-të duhet të mundësojnë

dërgimin e njoftimeve në mënyrë që pajtimtari të ketë kohë të përdorë njoftimin për të marrë një vendim në lidhje me shpenzimet e tij para se të arrihet kufiri përfundimtar. Në rastet kur ka një ndryshim nga 80%, ofruesit duhet të përpiqen për të siguruar që pajtimtarët të marrin mesazhin para se të arrijnë në 80% të kufirit të tyre dhe jo pas këtij kufiri.

139. AKEP sqaron se sipas pikës 6/3, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, njoftimi duhet t'u dërgohet pajtimtarëve me mjete të përshtatshme, për shembull, me një mesazh SMS, një e-mail ose një dritare pop-up në kompjuter. Lloji i mjetit për të dërguar njoftimin duhet të zgjidhet duke pasur parasysh pajisjen dhe llojin e shërbimit të të dhënave të përdorur.

140. Në mënyrë që t'u japin pajtimtarëve më shumë kohë për të planifikuar dhe kontrolluar përdorimin dhe shpenzimin e tyre, MNO-të, në njoftimin paralajmërues të arritjes së 80% të kufirit financiar ose sasior, mund të përfshijnë informacion për pajtimtarët se si të vazhdojnë përdorimin e internetit në roaming kur të arrihet niveli 100% i kufirit financiar ose sasior. Në këto raste përfshihet dhe informacioni për koston/tarifën e aplikueshme për çdo njësi shtesë të të dhënave në roaming të shprehur në ALL/MB apo ALL/GB. Nëse pajtimtari, pasi ka marrë mesazhin për 80%, vendos të autorizojë/japë pëlqimin për përdorimin e të dhënave përtej kufirit financiar ose sasior, atëherë MNO nuk ka nevojë që të dërgojë njoftim për arritjen e nivelit 100% të limitit. Pëlqimi i pajtimtarit për të vijuar përdorimin e internetit përtej kufirit financiar ose sasior jepet dhe është i vlefshëm vetëm për periudhën e specifikuar të faturimit.

141. Kur të arrihet kufiri financiar ose i vëllimit (5000 ALL/muaj pa TVSH ose kufi tjetër i zgjedhur), MNO është i detyruar të dërgojë një njoftim tjetër për pajtimtarin. Ky njoftim duhet të tregojë se si duhet të japë pëlqimin pajtimtari për të vazhduar përdorimin e internetit në roaming, nëse e dëshiron këtë, si dhe koston/tarifën e aplikueshme për çdo njësi shtesë të të dhënave në roaming të shprehur në ALL/MB apo ALL/GB. Nëse pajtimtari nuk përgjigjet siç kërkohet në njoftimin e marrë, MNO menjëherë pushon të ofrojë dhe të tarifojë klientin roaming për shërbimin e roaming-ut të të dhënave, përveç dhe derisa pajtimtari të kërkojë vazhdimin ose rinisjen e ofrimit të këtyre shërbimeve për periudhën përkatëse të faturimit.

142. AKEP sqaron se procedurat që pajtimtarët të japin pëlqimin e tyre për vazhdimin e përdorimit të internetit përtej kufirit financiar/sasior duhet të jenë të lehta dhe të maksimizojnë mundësitë e marrjes së njoftimeve përkatëse dhe të veprimeve të tyre për këto njoftime (dërgimin e pëlqimit) nëse dëshirojnë të vazhdojnë përdorimin e internetit përtej kufirit, duke marrë në konsideratë llojin e pajisjes dhe të të dhënave të përdorura prej tij.

143. Operatorët celularë gjatë këtyre dy vietev kanë shprehur shqetësimet e tyre se ky proces (cut-off) i detyron ata të ndërpresin të gjitha shërbimet data të pajtimtarit përkatës, dhe më pas klientit (pajtimtarit) roaming do t'i kërkohet të kontaktojë shërbimet e klientit të MNO-së për të kërkuar ri-autorizim të data roaming, dhe kjo mund të kërkojë një interval kohor të shkurtër ose të konsiderueshëm për t'u përpunuar nga MNO. Gjithashtu, gjatë këtij intervali kohor, të gjitha të dhënat në që janë në procesin e shkarkimit ose ngarkimit kur arrihet kufiri financiar/sasior do të humbasin. AKEP konsideron që qëllimi i FUP nuk është që shërbimet e roaming-ut të të dhënave të jenë të ri-autorizuara ose që konsumatorët të duhet të hyjnë në një

proces të rëndë ose të gjatë për të rifilluar përdorimin e roaming-ut të të dhënave, pr që MNO-të zbatojnë udhëzimin e mësipërm.

144. AKEP sqaron se në të gjitha rastet, tarifimi duhet të ndalojë kur të arrihet kufiri financiar 5000 ALL/muaj apo kufi tjetër i zgjedhur, përveç nëse pajtimtari është përgjigjur në kohën e duhur që ai nuk dëshiron që të aktivizohet ndërprerja. Lidhur me problemet që mund të krijohen nga ndërprerja automatike e aksesit në internet kur arrihet limiti, AKEP inkurajon MNO-të që, kur është e mundur, ta ruajnë lidhjen në internet për një periudhë të arsyeshme pasi të arrihet kufiri, për t'u dhënë shumicës së pajtimtarëve kohë të përshtatshme për të marrë dhe përgjigjur ndaj njoftimit, për shembull, duke pezulluar lidhjen në internet ose ngadalësuar ndjeshëm shpejtësinë. Në varësi të llojit të pajisjes, shërbimit të të dhënave dhe përmbajtjes, mund të ketë një vonesë në përgjigjen e klientit, veçanërisht kur mjetet e dërgimit të njoftimit nuk ndërpresin vetë sesionin e të dhënave, për shembull, kur dërgohet një SMS në një aparat celular, në krahasim me një dritare pop-up. Nëse klienti tregon se ai ose ajo nuk dëshiron të vazhdojë sesionin e të dhënave ose hesht gjatë gjithë "periudhës së arsyeshme" për një përgjigje, AKEP inkurajon operatorët të lehtësojnë çdo lidhje të mëvonshme në masën më të madhe të mundshme, pasi klienti të japë pëlqimin e tij për rifillim përdorimi të internetit. AKEP gjithashtu pret që MNO-të të bëjnë përpjekje teknikisht të mundshme për të ruajtur për një periudhë të arsyeshme pas arritjes së kufirit çdo të dhënë që ishte në proces shkarkimi para momentit të ndërprerjes automatike, në mënyrë që të lejojë klientin të rifillojë shkarkimin këtyre të dhënave.

145. AKEP sqaron se masat e mësipërme duhet të shihen si 'masa minimale mbrojtëse për klientët në roaming', dhe nuk i pengojnë MNO-të të ofrojnë masa të tjera shtesë për transparencën dhe kontrollin e shpenzimeve, si oferta me tarifë fikse dhe me mekanizëm *Cut-off* ose informacion në kohë reale për konsumin e të dhënave.

146. Së fundmi, sipas pikës 6/6, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, përcaktimet për kufirin financiar dhe sasior për kontrollin e shpenzimeve të internetit në roaming, janë të aplikueshme jo vetëm për roaming në vendet e Ballkanit Perëndimor, por dhe për roaming-un në të gjitha vendet e tjera. Këto përcaktime nuk aplikohen vetëm nëse operatori i rrjetit të vizituar në ndonjë vend jashtë Ballkanit Perëndimor, nuk i mundëson MNO-së së Republikës së Shqipërisë të monitorojë përdorimin e shërbimeve të klientit të tij në kohë reale. Në këto raste, për të cilat MNO-të janë të mirinformuar nga marrëveshjet/marrëdhëniet roaming që ata kanë, MNO i dërgon pajtimtarit një njoftim me mesazh SMS kur hyn në një vend të tillë, pa vonesa të panevojshme dhe pa pagesë, që informacioni mbi konsumin e akumuluar dhe garancia që klientit të mos kalojë kufirin e specifikuar financiar nuk janë të disponueshme gjatë roaming-ut në këtë shtet.

IX. Intervalet e tarifimit

147. Vendimet nr. 22-24/2019 të AKEP përmbajnë përcaktime për intervale maksimale të tarifimit për shërbimet e rregulluara të roaming-ut me shumicë dhe me pakicë, të thirrjeve telefonike dhe të të dhënave. Për thirrjet roaming të kryera dhe të marra (dalëse dhe hyrëse) në Ballkanin Perëndimor, MNO-të duhet të tarifojnë në bazë sekonde kohë fillestare tarifimi jo më të gjatë se 30 sekonda. Ndërsa për përdorimin e internetit në roaming në Ballkanin Perëndimor, tarifimi i të dhënave duhet të jetë në bazë *kilobyte*. AKEP sqaron se qëllimi i vendimeve nr. 22-24/2019 si dhe marrëveshjes roaming të Ballkanit Perëndimor (RRA) është implementimi i modelit RLAH, pra, që pajtimtarët të përfitojnë në roaming në Ballkanin Perëndimor të njëjtat tarifa si dhe në Shqipëri (apo vendet përkatëse të pajtimtarëve të BP). Në këtë mënyrë, MNO-të kanë detyrim të aplikojnë intervalet e cituara të tarifimit për pajtimtarët e tyre në roaming në Ballkanin Perëndimor vetëm për tarifën shtesë roaming (*surcharge*), ndërsa për rastet kur nuk ka tarifim shtesë roaming, pra, tarifa roaming është e njëjtë si në Shqipëri, MNO-të mund të përdorin intervalet e tarifimit sikundër pajtimtari të ishte në Shqipëri. Megjithatë, MNO-të nuk janë të ndaluar që të aplikojnë intervalet e cituara të tarifimit edhe për elementin e tarifës brenda vendit, nëse kjo është më e përshtatshme për operatorët dhe njëkohësisht në përfitim të pajtimtarit.

148. SMS-të duhet të faturohen në bazë mesazhi, si në nivelin me shumicë, ashtu edhe në atë me pakicë, dhe karakteristikat teknike të SMS (numri i karaktereve për 1 SMS) në roaming duhet të jenë të njëjta me ato në Shqipëri.

X. Tarifimi për mesazhet e postës zanore dhe SMS e marra

149. Sipas pikës 4/4, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, MNO-të nuk duhet të aplikojnë tarifë shtesë për pajtimtarët e tyre për shërbimin e rregulluar të SMS-ve të marra në roaming dhe mesazhet e postës zanore (*voicemail*) të marra (depozituar në kutinë e postës e zanore gjatë roaming-ut në Ballkanin Perëndimor). Pra këto shërbime janë pa pagesë (nuk aplikohet as tarifë brenda vendit dhe as tarifë shtesë roaming).

150. Megjithatë, MNO-të nuk janë të ndaluar të aplikojnë tarifatat përkatëse për dëgjimin e mesazheve zanore, apo dërgimin e mesazheve zanore nga rrjeti i vizituar në roaming në rrjetin e operatorit të vet në Shqipëri.

XI. Kursi i Këmbimit për konvertimin e tarifave shtesë roaming nga Euro në Lekë

151. Tavanet e tarifave shtesë roaming me pakicë si dhe të tarifave totale roaming me pakicë (tarifa brenda vendit+tarifa shtesë roaming) në vendimet nr. 22-24/2019 të AKEP, janë dhënë në Euro, dhe duhet të konvertohen në LEK duke përdorur Kursin Mesatar të Këmbimit Lek/Euro të tremujorit të parë të vitit përkatës, sipas publikimit të Bankës së Shqipërisë në raportet periodike tremujore ose llogaritjeve në bazë të të dhënave në faqen web të BSH, për periudhën 1 janar - 31 mars të vitit përkatës. Kursi Mesatar i Këmbimit i llogaritur nga AKEP (1 Euro=125 ALL) për t'u përdorur në fazën e parë të rregullimit (1.7.2019 - 30.6.2020) ishte

pjesë e vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP. Për periudhën e dytë të rregullimit (1.7.2020 - 30.6.2021) AKEP njoftoi MNO-të me shkresë për Kursin Mesatar të Këmbimit (1 Euro= 123 ALL në 1.1.2020 - 31.3.2020) për t'u përdorur për tarifatat përkatëse me pakicë roaming (shtesë dhe totale).

152. Bazuar në të dhënat e publikuara në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, Kursi Mesatar i Këmbimit Euro/ALL për periudhën 1.1.201 - 31.3.2021 i llogaritur nga AKEP rezulton të jetë 1 Euro = 123 ALL. Bazuar në këtë kurs këmbimi AKEP ka llogaritur tavanet përkatëse të tarifave shtesë roaming dhe tarifave totale roaming që do shërbejnë si tavane për periudhën 1.7.2021 - 31.12.2021, të cilat janë përfshirë në tabelën e mëposhtme, të shprehura në Euro pa TVSH, ALL pa TVSH dhe ALL me TVSH.

Tabela: __ Tarifatat maksimale me pakicë për roaming-un me BP sipas modelit RLAH (1.7.2021 - 31.12.2021).

		Thirrjet e rregulluara roaming dalëse (Minute)	Thirrjet e rregulluara roaming hyrëse (Minute)	SMS e rregulluara roming të dërguar (SMS)	Transmetimi i të dhënave BP (MB)
Euro pa TVSH	Tarifa shtesë roaming (surcharge)	0.032	0.016	0.01	0.0077
	Tarifa totale roaming (domestic+surcharge)	0.19	0.016	0.06	0.18
Lek pa TVSH	Tarifa shtesë roaming (surcharge)	3.94	1.97	1.23	0.95
	Tarifa totale roaming (domestic+surcharge)	23.37	1.97	7.38	22.14
Lek me TVSH	Tarifa shtesë roaming (surcharge)	4.73	2.36	1.48	1.14
	Tarifa totale roaming (domestic+surcharge)	28.04	2.36	8.86	26.57

153. Tabela e mëposhtme paraqet tavanet për tarifatat shtesë me pakicë dhe tarifatat totale me pakicë për roaming-un në Ballkanin Perëndimor (dhe Kosovë), të shprehura në Lekë me TVSH, për fazën e dytë (aktuale) dhe fazën e tretë të rregullimit të roaming-ut sipas modelit RLAH që fillon më datë 1.7.2021.

Tabela: __ Tarifatat maksimale me pakicë për roaming-un me BP dhe Kosovën 1.7.2020 - 31.12.2021 (në ALL me TVSH).

	Faza e Rregullimit	Thirrjet e rregulluara roaming dalëse (Minute)	Thirrjet e rregulluara roaming hyrëse (Minute)	SMS e rregulluara roming të dërguar (SMS)	Transmetimi i të dhënave BP (MB)	Transmetimi i të dhënave Kosovë (MB)
Tarifatat shtesë	1.7.2020 - 30.6.2021	7.38	3.70	2.95	2.22	1.26

roaming (surcharge)	1.7.2021 - 31.12.2021	4.73	2.36	1.48	1.14
Tarifa totale roaming (Domestic + surcharge)	1.7.2020 - 30.6.2021	28.04	3.70	8.86	26.57
	1.7.2021 - 31.12.2021	28.04	2.36	8.86	26.57

154. AKEP do t'i dërgojë me shkresë MNO-ve informacionin e mësipërm për kursin e këmbimit për t'u përdorur për tarifën me pakicë roaming në Ballkanin Perëndimor për periudhën 1.7.2021 - 31.12.2022, si dhe do të vijojë këtë komunikim për periudhat e tjera të rregullimit.

155. AKEP sqaron se sipas marrëveshjes RRA të Ballkanit Perëndimor si dhe vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, tavanet e tarifave me shumicë roaming, dhe për rrjedhim tavanet për tarifën shtesë roaming me pakicë (të shprehura në euro) që mund të aplikohen sipas përcaktimeve të Rregullores së FUP në modelin RLAH, duke filluar nga 1.7.2021 qëndrojnë të pandryshuara deri më 1 janar 2026 (e në vijim) për shërbimet e rregulluara roaming të thirrjeve dalëse (të kryera), thirrjet hyrëse (të marra) dhe SMS-të. Ndryshim në këtë periudhë do të ketë vetëm tarifa maksimale me shumicë/tavani për tarifën shtesë roaming me pakicë të të dhënave, e cila, pas 1.7.2021 vijon me reduktim të përshkallëzuar në çdo datë 1 janar për vitet 2022-2026. Ndërkohë, konvertimi i tavaneve të tarifave në euro do të sjellë ndryshim edhe në vlerat në lekë. Për konvertimin e këtyre vlerave nga euro në lekë në periudhat e rregullimit që fillojnë më 1.1.2022 e në vijim, do të përdoret kursi mesatar i tremujorit të tretë të vitit paraardhës: Tremujori i tretë 2021 për vitin 2022, e kështu në vijim.

XII. Roaming-u i padëshiruar

156. Sipas pikave 5/4 dhe 6/5, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, MNO-të t'i vënë në dispozicion pajtimtarëve të tyre informacionin se si të shmangin roaming-un e padëshiruar në rajonet kufitare si dhe të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të mbrojtur pajtimtarët e tyre nga pagesa e tarifave për roaming e padëshiruar ndërsa ndodhen në Shqipëri. Në kuadër të fillimit të implementimit të RLAH si dhe kufijve të aplikueshëm për FUP dhe treguesve objektivë për të shmangur përdorimin abuziv të shërbimeve roaming, MNO-të duhet të ndërmarrin hapa për të zvogëluar dëmtimin e pajtimtarëve që mund të vijë nga shkelja e kufijve ose treguesve të FUP-it për shkak të roaming-ut të padëshiruar. Këto hapa mund të përfshijnë bashkërendimin ndërkufitar (me ndërmjetësimin dhe/ose marrëveshjet përkatëse të AKEP dhe NRA-ve të vendeve kufitare) për nivelet e fuqisë, transmetimit dhe ndjeshmërisë së antenave. Duke pasur parasysh se sinjalet radio nuk mund të kontrollohen tërësisht për të respektuar kufijtë tokësorë, dhe në rast se masat teknike nuk mund të zbusin efektet e roaming-ut të padëshiruar në zonat kufitare, atëherë MNO-të mund të marrin në konsideratë zbatimin e tarifave speciale, ose

Mekanizmat e Ndalimit të Përcaktuara nga Operatori, për ata pajtimtarë që jetojnë afër me zonat kufitare dhe/ose njoftimin me SMS, ose dhënien e pëlqimit ndoshta përmes menusë së pajisjes celulare, përpara se të lejohet përdorimi i roaming për ata pajtimtarë që mund të preken nga roaming-u i padëshiruar, veçanërisht në zonat kufitare me vendet e Ballkanit Perëndimor (Mali i Zi, Kosovë dhe Maqedoni). Në çdo rast, operatorët celularë duhet të informojnë klientët e tyre për masat për parandalimin e roaming të padëshiruar (p.sh., zgjedhja manuale e operatorit kur pajisja celulare përdoret afër zonave kufitare).

XIII. Planet tarifore pa shërbime roaming

157. AKEP sqaron se vendimet nr. 22-24/2019 nuk i detyrojnë MNO-të që të ofrojnë shërbime roaming në planet e tyre tarifore. Praktika në tregun celular në Shqipëri është që të gjithë përdoruesit e planeve tarifore me parapagim e kanë të aktivizuar shërbimin e roaming-ut (në Ballkanin Perëndimor dhe vende të tjera), ndërsa përdoruesit me paspagim kanë mundësi zgjedhje për përdorimin ose jo të shërbimeve roaming, dhe në raste të caktuara për këtë kategori përdoruesish MNO-të kërkojnë vendosjen e garancive financiare nga pajtimtarët për përdorim të shërbimeve roaming për të shmangur rrezikun e borxheve të këqija nga mospagimi i faturave të larta që mund të rezultojnë nga përdorimi i shërbimeve roaming. Megjithatë, në vijim të sqarimeve të dhëna në pikën 9 të këtyre udhëzimeve, AKEP thekson se MNO-të nuk lejohen të aplikojnë tarifë ekstra (garancitë nuk konsiderohen tarifë ekstra) jo vetëm për shërbimet, por edhe as ndonjë tarifë të përgjithshme për të mundësuar përdorimin e shërbimeve roaming sipas regjimit RLAH në Ballkanin perëndimor, përveç atyre të lejuara sipas përcaktimeve të vendimeve nr. 22-24/2019 dhe Rregullores së FUP të AKEP (për më shumë shiko Udhëzimin 9, si dhe përcaktimet në kapitujt II, III dhe IV të këtij Udhëzimi).

158. Kalimi/transferimi midis planeve tarifore *me* ose *pa* shërbime roaming duhet të ndjekë të njëjtat procedura si kalimi midis planeve tarifore të tjera të zakonshme në Shqipëri. Vetëm pajtimtari ka të drejtë të fillojë një proces ndryshimi plani tarifor dhe gjithashtu pajtimtari duhet të japë pëlqimin e shprehur përpara çdo ndryshimi plani tarifor. Mekanizmat për ndryshim të thjeshtë dhe të shpejtë midis planeve tarifore *me* ose *pa* roaming nuk duhet të përdoren nga operatorët për të anashkaluar përcaktimet e vendimeve nr. 22-24/2019 dhe Rregulloren e FUP të AKEP.

XIV. Komunikimet makinë-makinë (M2M)

159. Vendimet nr. 22-24/2019 dhe Rregullorja e FUP e AKEP ka përfshirë si objekt rregullimi si dhe përcaktime duke iu referuar pajtimtarëve të operatorëve të MNO-ve të Republikës së Shqipërisë që udhëtojnë në mënyrë periodike në vendet e Ballkanit Perëndimor. Pika 6/4 e vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP sqaron se detyrimet e MNO-ve për transparencën për shërbimin data roaming nuk aplikohen për komunikimet M2M. Përcaktimet e këtyre akteve të AKEP përmbajnë dhe masa që mund të ndërmarrin MNO-të e Republikës së Shqipërisë për të

shmangur përdorimin abuziv dhe anormal të shërbimeve roaming në Ballkanin Perëndimor në kuadër të RLAH, përfshirë roaming-un e përhershëm. Megjithatë, me zhvillimet teknologjike, është e zakonshme që pajisjet për komunikimet M2M të përdoren në baza të përhershme roaming. Për këtë arsye, AKEP sqaron se komunikimet M2M, duhet të trajtohen rast pas rasti, në komunikim të AKEP me MNO-të për analiza më të detajuara, duke marrë parasysh përcaktimet e dokumenteve përkatës të KE dhe BEREC për këtë çështje/raste specifike.

XV. Roli i AKEP në lidhje me FUP/zgjidhje mosmarrëveshje

160. Në përputhje me nenin 5 (2), të Rregullores së FUP, MNO-të njoftojnë AKEP për çdo FUP që ata mund të aplikojnë për roaming-un në Ballkanin Perëndimor. MNO duhet t'i dërgojë AKEP informacion të plotë mbi FUP përpara se të publikohet dhe në çdo rast përpara se të zbatohet. AKEP sqaron se detyrimi për njoftim nuk nënkupton që AKEP do të miratojnë formalisht FUP-in nëpërmjet një autorizim paraprak apo vendimi. Sidoqoftë, AKEP sqaron se në kuadër të përcaktimeve të ligjit 9918/2008, AKEP do të vlerësojë informacionin e dërguar nga MNO-të për FUP për të verifikuar nëse është në përputhje me përcaktimet vendimeve nr. 22-24/2019 dhe të Rregullores së FUP, si dhe akteve të tjera nënligjore të zbatueshme. AKEP gjithashtu ka të drejtë të ndërhyjë dhe me iniciativën e vet apo nga informacioni i marrë nga palë të interesuara, në rastet kur evidenton probleme të implementimit dhe përputhshmërisë së FUP të MNO-ve me Rregulloren e FUP të AKEP, duke kërkuar korrigjimin e gabimeve/shkeljeve si dhe duke marrë masat përkatëse penalizuese të parashikuara nga ligjit 9918/2008.

161. Në lidhje me njoftimin e AKEP për rastet e rishitjes së organizuar të kartave SIM dhe masat që duhen marrë në përputhje me nenin 5 (6), të Rregullores së FUP, MNO duhet të njoftojë AKEP si për provat e rishitjes së organizuar, ashtu edhe për masat që ndërmerren nga MNO në të njëjtën kohë. Në rastet kur një MNO konstaton se po ndodh një abuzim i tillë, ai do t'i përcjellë AKEP provat që karakterizojnë abuzimin sistematik në fjalë dhe masën e marrë, për të siguruar respektimin e të gjitha kushteve të kontratës së pajtimit, jo më vonë se kohën kur ndërmerren masa të tilla nga MNO-ja. AKEP vlerëson se mund të ketë raste individuale që mund të kërkojnë analiza më të hollësishme nga AKEP për abuzimet dhe masat e ndërmarra nga MNO.

162. Në lidhje me procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve pajtimtar-operator, AKEP do të veprojë sipas përcaktimeve të ligjit 9918/2008 si dhe akteve nënligjore në fuqi për zgjidhjen e këtyre lloj mosmarrëveshjesh. Në përputhje me nenin 5 (3), të Rregullores së FUP, si pjesë e këtyre procedurave, klienti roaming ka mundësinë të sigurojë prova që kundërshtojnë çdo gjetje nga MNO të përdorimit abuziv ose anormal të shërbimeve të rregulluara me pakicë në roaming në Ballkanin Perëndimor për qëllime të tjera nga udhëtimi periodik, pasi t'i ketë dërguar një njoftim klientit në roaming. AKEP rekomandon si praktikë të mirë që MNO të mos imponojë në mënyrë efektive tarifa shtesë roaming (p.sh., duke e përfshirë këtë tarifim në

faturën mujore) për një klient që ka depozituar një ankesë apo filluar një procedurë zgjidhje mosmarrëveshje derisa ajo të zgjidhet.

XVI. Garantimi i qëndrueshmërisë së RLAH

163. Në përputhje me përcaktimet e pikën 4/7, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, në rrethana specifike dhe të jashtëzakonshme, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së modelit të tarifimit brenda vendit (në Shqipëri), një MNO mund të kërkojë autorizim nga AKEP për të aplikuar një tarifë shtesë roaming. Rregullorja e FUP përcakton rregulla të hollësishme mbi metodologjinë për vlerësimin e qëndrueshmërisë së heqjes së tarifave shtesë me pakicë roaming dhe për aplikimin që duhet të paraqitet nga një MNO për qëllimet e këtij vlerësimi.

1. Afatet

164. Afatet për aplikimin nga operatorët celularë për autorizim/miratim të zbatimit të tarifave shtesë roaming në Ballkanin Perëndimor për të garantuar qëndrueshmërinë e modelit të tarifimit në Shqipëri, janë dhënë në nenin 10, të Rregullores së FUP. Operatorët mund të kryejnë aplikim në AKEP në çdo kohë pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të Rregullores së FUP. Megjithatë, operatorët celularë duhet të marrin në konsideratë edhe kërkesat e informacionit të përcaktuara në rregullore për këto aplikime. Pika 7, e nenit 10, të Rregullores së FUP përcakton që AKEP brenda një muaji nga marrja e kërkesës do të miratojë apo refuzojë kërkesën. Ky paragraf i Rregullores së FUP përcakton gjithashtu se AKEP mund të zgjasë deri me 2 muaj shtesë afatin e vendimit final, nëse vlerëson se kërkesa është qartësisht e pabazuar ose nuk përmban informacion të mjaftueshëm, Gjatë kësaj periudhe, AKEP do t'i japë operatorit aplikues mundësinë që të marrë pjesë në një seancë dëgjimore në AKEP. Vendimi final i AKEP mund të jetë për miratim/autorizim, ndryshim ose refuzim/mos-pranim të kërkesës për të aplikuar tarifë shtesë roaming.

165. Miratimi/autorizimi i AKEP për aplikimin e tarifave shtesë të qëndrueshmërisë do të jetë për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj. Për të rinovuar autorizimin, operatori celular duhet ta përditësojë informacionin dhe ta dorëzojë atë në AKEP çdo 12 muaj, në përputhje me pikën 8, të nenit 10, të Rregullores së FUP.

166. Në rast të miratimit/autorizimit nga AKEP, operatorët që kërkojnë të aplikojnë pagesa shtesë duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e transparencës të ligjit 9918/2018 dhe akteve nënligjore të AKEP për shërbimet brenda vendit dhe ato në roaming (d.m.th., publikim i avancuar i ndryshimeve të çmimeve, çështjet kontraktuale që kërkojnë një të drejtë të jashtëzakonshme për të ndërprerë kontratat).

2. Kërkesat për të aplikuar për një përjashtim

167. Një operator që aplikon për të marrë autorizim/miratim për të aplikuar tarifa shtesë për roaming në Ballkanin Perëndimor, duhet të depozitojë në AKEP vlerësimin e marzhit neto të shërbimeve me pakicë roaming në Ballkanin Perëndimor për një periudhë 12 mujore, dhe që fillon jo më herët se 1 korrik 2021. Marzhi i tij i parashikuar i shitjes me pakicë të shërbimeve

roaming, në rast se ai është negativ, do të krahasohet me marzhin e parashikuar të shërbimeve celulare. Në rast se vlera absolute e marzhit neto të shitjes me pakicë të shërbimeve roaming është e barabartë ose më e madhe se 3% e vlerës së marzhit të tij të shërbimeve celulare, AKEP do të shqyrtojë rrethanat specifike të përmendura në nenin 10, pika 2, të Rregullores së FUP, në mënyrë që të arrijë në përfundimin nëse duhet të autorizohet aplikimi i një tarife shtesë roaming mbi shërbimet e rregulluara të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor. Sipas përcaktimit të pikës 2/f, të nenit 2, të Rregullores së Roaming, "marzhi i shërbimeve celulare" do të thotë fitimi nga shitja e shërbimeve celulare, përveç shërbimeve me pakicë roaming në Ballkanin Perëndimor, përpara interesave, taksave, zhvlerësimit dhe amortizimit. MNO-të në Shqipëri ofrojnë shërbime celulare me pakicë dhe me shumicë, dhe në këtë mënyrë marzhi i shërbimeve celularë duhet të përfshijë të ardhurat dhe kostot për shërbimet e shitjes me pakicë dhe me shumicë të operatorit celular (për shmangien e dyshimit, në këtë vlerësim nuk përfshihen shërbimet e shitjes me pakicë të roaming në Ballkanin Perëndimor).

168. Marzhi neto i shitjes me pakicë të roaming është vlera që rezulton nga diferenca e të ardhurave nga shërbimet e rregulluara me pakicë roaming në Ballkanin Perëndimor me kostot e ofrimit të këtyre shërbimeve. Kostot dhe të ardhurat duhet të përcaktohen sipas parashikimeve të neneve 7, 8 dhe 9 të Rregullores së FUP. Sipas pikës 2, të nenit 6, të Rregullore së FUP, çdo e dhënë për kostot dhe të ardhurat e aplikantit bazohet në llogaritë financiare të operatorit, të cilat do të vihen në dispozicion të AKEP dhe mund të korrigjohen sipas vlerësimeve të vëllimeve të shërbimeve në përputhje me pikën 1, të nenit 6, të Rregullores së FUP. Kur parashikohen kostot, devijimet nga shifrat që vijnë nga pasqyrat financiare të viteve të mëparshme do të konsiderohen vetëm nëse mbështeten me prova të angazhimeve financiare për periudhën e mbuluar nga parashikimet. Për përcaktimin e marzhit neto shërbimeve me pakicë roaming, të ardhurat dhe kostot duhet të vlerësohen në lidhje me të gjitha shërbimet e rregulluara me pakicë të roaming në Ballkanin Perëndimor dhe jo vetëm për disa tarifa/plane tarifore të përzgjedhura. Aplikuesi do të sigurojë të gjitha të dhënat e nevojshme aktuale dhe të parashikuara që ai ka përdorur për të përcaktuar marzhin e parashikuar të shërbimeve celulare, kostot dhe të ardhurat e përgjithshme, aktuale dhe të parashikuara, të ofrimit të shërbimeve të rregulluara të roaming gjatë periudhës përkatëse (periudha 12-mujore aktuale dhe e parashikuar, për të cilën paraqitet kërkesa).

169. Në mungesë të raportimit dhe/ose publikimit nga MNO-të të të dhënave financiare mbi baza tre-mujore, të dhënat aktuale të kostove dhe shërbimeve është më e përshtatshme që të paraqiten për një periudhë 12-mujore, e cila përkon me mbylljen e vitit financiar, që në Shqipëri është e njëjtë me vitin kalendarik. Për shembull, nëse paraqitet një kërkesë në vitin 2022, duhet të dorëzohen të dhënat aktuale për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2021, nëse janë të disponueshme. Në rast se periudha e vlerësimit të aplikimit nga AKEP zgjatet me dy muaj të tjerë, sipas parashikimeve të pikës 7, të nenit 10, të Rregullores së FUP, dhe ndërkohë të dhënat më të fundit aktuale bëhen të disponueshme, aplikuesi mund të përfshijë në kërkesën e tij këto të dhëna shtesë aktuale. Lidhur me të dhënat e parashikuara, aplikuesi duhet të paraqesë, përveç rezultateve të parashikimit të tij, dhe inputet e përdorur për të nxjerrë këto

parashikime dhe hollësi të metodologjisë së tij të parashikimit. Më poshtë është një listë me dokumente/informacionin që duhet të depozitohet operatori aplikues në mënyrë që AKEP të shqyrtojë qëndrueshmërinë e modelit të tarifimit brenda vendit të operatorit:

- Skedari në format Excel në Aneks I të këtyre udhëzimeve, i cili duhet të plotësohet në mënyrën e duhur nga operatori aplikues. Skedari model përmban të dhënat/informacionet e mëposhtme aktuale dhe të parashikuara:
 - rezultati i formulave të përfshira në Aneksin II të Rregullores së FUP;
 - të dhënat e përdorura për llogaritjen e formulave të përfshira në Aneksin II të Rregullores së FUP;
 - kostot sipas përcaktimeve në nenet 7 dhe 8, të Rregullores së FUP;
 - të ardhurat sipas nenit 9, të Rregullores së FUP;
 - llogaritja e marzhit neto të shërbimeve me pakicë roaming, bazuar në llogaritjet e mëparshme të kostove dhe të ardhurave;
 - llogaritja e marzhit të shërbimeve celulare (EBITDA);
 - informacion shtesë sipas pikës 2, të nenit 10, të Rregullores së FUP;
- Për çdo parashikim (d.m.th., çdo rresht në skedarin në excel) detaje mbi metodologjinë e parashikimit të përdorur, duke iu referuar provave në lidhje me angazhimin financiar (nëse është e aplikueshme).
- Bilancet e librave të përgjithshëm të llogarive që mbulojnë transaksionet gjatë periudhës "aktuale", përfshirë alokimin e vlerave monetare në pasqyrat financiare në qendrat e kostove të operatorit aplikues (d.m.th., pjesët e organizatës së cilës i atribuohen kostot për qëllime të kontabilitetit).
- Detaje mbi lidhjen/alokimin midis vlerave monetare në llogaritë/pasqyrat financiare dhe vlerave të përfshira në skedarin në excel.

170. AKEP sqaron gjithashtu se operatori celular aplikues duhet të shoqërojë kërkesën për autorizim për aplikim të tarifave shtesë roaming me një deklaratë të Drejtorit të Përgjithshëm të Financave (CFO) të sipërmarrësit ose ekspertit kontabël të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, që të dhënat e deklaruara janë nxjerrë në mënyrë të saktë nga sistemet e tij të biznesit dhe se metodologjia për parashikimet është ndjekur në mënyrë të qëndrueshme dhe korrekte në përputhje me përcaktimet e Rregullores së FUP të AKEP.

171. Sipas përcaktimit në nenin 2 (f), të Rregullores së FUP, EBITDA për shërbimet celulare duhet të llogaritet duke mos përfshirë kostot dhe të ardhurat nga shërbimet me pakicë të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor. Në rast se një operator has vështirësi në llogaritjen e marzhit të shërbimeve celulare (d.m.th., EBITDA) ai mund të konsiderojë të përdorë si një përafërues (proxy) të mirë vlerën që rezulton nga diferenca midis EBITDA e të gjithë shërbimeve celulare të ofruara nga operatori me marzhin neto të shërbimeve me pakicë roaming, të llogaritur sipas neneve 6, 7 dhe 8, të Rregullores së FUP. Megjithatë, nëse operatori përdor këtë metodë, ai nuk duhet të vlerësojë EBITDA të shërbimeve celulare në atë mënyrë që të rezultojë në anashkalimin e metodologjisë për vlerësimin e kostove dhe të ardhurave (pra

dhe të marzhit neto) të shërbimeve roaming, të përshkruar në nenet 6, 7 dhe 8, të Rregullores së FUP.

172. Duke marrë parasysh Udhëzimin nr. 181, operatori aplikues gjithashtu duhet të paraqesë informacion mbi nivelin dhe shpërndarjen e tarifave shtesë të roaming që ai propozon të aplikojë, në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmërinë e modelit të tij të tarifimit brenda vendit duke marrë parasysh faktin se niveli i tarifave shtesë të roaming nuk duhet të shkojë përtej mbulimit të kostos.

3. Vlerësimi i aplikimit

173. Në përputhje me nenin 10/1, të Rregullores së FUP, AKEP mund të arrijë në përfundimin se operatori aplikues nuk është në gjendje të mbulojë/rikuperojë kostot e tij për ofrimin e shërbime të rregulluara me pakicë të roaming në Ballkanin Perëndimor me modelin RLAH, dhe kjo dëmton qëndrueshmërinë e modelit të tarifimit të operatorit për shërbimet e ofruara brenda vendit (në Shqipëri), vetëm kur marzhi neto i shërbimeve me pakicë të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor është negativ dhe i barabartë me 3% ose më i madh se vlera e marzhit të shërbimeve të tij celulare roaming ose në rast të një marzhi negativ të shërbimeve celulare.

174. Marzhi neto me pakicë i roaming do të jetë vlera që rezulton nga diferenca midis të ardhurave nga ofrimi i shërbimeve të rregulluara me pakicë të roaming në Ballkanin Perëndimor me kostot e ofrimit të këtyre shërbimeve, duke përdorur metodologjinë e përshkruar në nenet 7, 8 dhe 9, të Rregullores së FUP. Në këtë aspekt, AKEP do të shqyrtojë qasjen/metodologjinë e përdorur nga operatori në aplikimin e dërguar për të përcaktuar marzhin neto me pakicë të roaming, për të siguruar se ajo është në përputhje me metodologjinë për përcaktimin e kostove dhe të ardhurave, sipas përcaktimeve në nenet 7, 8 dhe 9, të Rregullores së FUP.

175. Nëse vlera absolute e marzhit neto me pakicë të roaming (kur është negative vetëm) është e barabartë ose më e madhe se 3% e marzhit të shërbimeve celulare, AKEP mund të refuzojë kërkesën për aplikim të tarifave shtesë roaming në Ballkanin Perëndimor, kur, në rrethana specifike, ka prova të një modeli të qëndrueshëm të tarifimit të shërbimeve celulare në Shqipëri. Rrethana të tilla përfshijnë situata të përshkruara në nenin 10, të Rregullores së FUP.

176. Së pari, AKEP do të shqyrtojë nëse operatori aplikues është pjesë e një grupi dhe qasja/metodologjia e përdorur në aplikimin e tij sugjeron që të aplikohen çmime transferimi të brendshëm nga/drejt filialeve të grupit në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht në raste të një disekuilibri të konsiderueshëm të tarifave me shumicë të roaming të aplikuara brenda grupit. Në raste të tilla, AKEP mund të arrijë në përfundimin se pjesa e kostove që i atribuohen operatorit aplikues është disproporcionalisht (tepër) e lartë (në krahasim me ato të filialeve të tjerë të grupit) dhe AKEP mund të refuzojë miratimin e mundësisë së aplikimit të tarifave shtesë roaming për të garantuar qëndrueshmërinë e tarifimit brenda vendit. Së dyti, AKEP do të shqyrtojë nivelin e konkurrencës në tregun celular në Shqipëri në mënyrë që të vlerësojë nëse niveli i marzheve të fitimit është i tillë që kompanitë celulare në Shqipëri kanë

më shumë mundësi të absorbojnë marzhin negativ të ofrimit të shërbimeve me pakicë roaming në Ballkanin Perëndimor, sesa të rritin çmimet e shërbimeve celulare në Shqipëri. Së treti, AKEP do të sigurojë që çdo supozim i bërë në aplikim/kërkesë nuk tejkalon ato që janë të nevojshme për të përmbushur kushtet e FUP, të përcaktuara në Rregulloren e FUP. Meqenëse qëllimi dhe kushtet e FUP janë dhe mund të kufizojnë humbjet e operatorit aplikues nga RLAH në Ballkanin Perëndimor, një operator aplikues nuk mund ta mbështesë kërkesën/aplikimin e tij në humbjet që mund të pësojë nga roaming-u RLAH në Ballkanin Perëndimor, mbi bazën e një FUP të hartuar prej tij dhe që është tepër 'bujar' (p.sh., duke ofruar roaming të pakufizuar të të dhënave dhe/ose duke mos kërkuar prova për lidhje të qëndrueshme, duke ofruar sasi minimale limit të të dhënave roaming më shumë se kërkohet nga rregullorja e FUP, si edhe duke mos shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e tjerë në dispozicion për FUP) në krahasim me ato që janë të nevojshme për të përmbushur kushtet e FUP-it, në Rregulloren e FUP. Në raste të tilla, AKEP do të refuzojë kërkesën për aplikimin e tarifave shtesë roaming.

4. Niveli dhe shpërndarja e tarifave shtesë roaming për të garantuar qëndrueshmërinë e RLAH

177. Në rastet kur AKEP miraton apo autorizon aplikimin e tarifave shtesë për shërbimet e rregulluara të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor, vendimi përfundimtar i AKEP do të identifikojë vlerën e konstatuar të marzhit negativ të shërbimeve me pakicë të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor që mund të mbulohet/rikuperohet përmes aplikimit të një tarife shtesë roaming për shërbimet me pakicë të roaming-ut të ofruara në vendet e Ballkanit Perëndimor. Nëse AKEP miraton aplikimin e tarifave shtesë roaming, operatori celular mund të aplikojë tarifa me pakicë shtesë roaming në Ballkanin Perëndimor për një periudhë prej 12 muajsh, përveç rasteve kur AKEP kërkon ndryshime në tarifatat shtesë roaming, në përputhje me pikën 8, të nenit 10, të Rregullores së FUP.

178. Pika 4, e nenit 10, të Rregullores së FUP përcakton se pagesa shtesë do të jetë në përputhje me supozimet e trafikut roaming që mbështet vlerësimin e aplikimit dhe do të vendoset në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 9918/2008.

179. Gjithashtu, në përputhje me pikën 4/7, të vendimeve nr. 22-24/2019 të AKEP, operatorët celularë të Republikës së Shqipërisë si ofruar të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor, mund të kërkojnë nga AKEP për dhënien e autorizimit për të aplikuar një tarifë shtesë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga AKEP. Nëse miratohet, tarifa/tarifatat shtesë do të zbatohet vetëm në masën e nevojshme për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë në Ballkanin Perëndimor, duke marrë parasysh tarifatat maksimale me shumicë roaming në Ballkanin Perëndimor në periudhën përkatëse. Pra, këto tarifa shtesë me pakicë në çdo rast nuk mund të jenë më të larta se tarifatat përkatëse me shumicë të roamig-ut në Ballkanin Perëndimor (pika 3, e nenit 1, të Rregullores së FUP).

180. Gjatë vlerësimit të nivelit të tarifave shtesë roaming të qëndrueshmërisë, AKEP do të sigurojë që niveli i këtyre tarifave shtesë roaming të mos tejkalojë ato që janë të nevojshme

për rikuperimin e kostove. Në këtë mënyrë, AKEP do të marrë parasysh çdo FUP të zbatuar nga operatori dhe vëllimet potenciale që tejkalojnë FUP (dhe që rezultojnë me pagesa shtesë). Megjithatë, operatorët celularë nuk lejohet të aplikojnë tarifën/tarifat shtesë të qëndrueshmërisë mbi tarifat shtesë roaming, sipas Kapitullit I dhe II, të Rregullores së FUP (tarifa shtesë për tejkalime të kufijve sasiore të FUP).

181. Si pjesë e aplikimit të tij, operatori aplikues duhet të demonstrojë se tarifat shtesë të qëndrueshmërisë të propozuara prej tij sigurojnë vijimin e qëndrueshmërisë së modelit të tarifimit brenda vendit (në Shqipëri) dhe në të njëjtën kohë, nuk tejkalojnë ato që janë të nevojshme për rikuperimin e kostove. Për këtë arsye, operatori aplikues duhet të propozojë se ndaj cilave shërbime të rregulluara të roaming-ut në Ballkanin Perëndimor (thirrjet e kryera/dalëse ose të marra/hyrëse, SMS të dërguar, shërbimin e të dhënave) apo tarifa (të gjitha tarifat, tarifat specifike, etj.) do të duhet të aplikohet tarifë shtesë roaming për qëndrueshmërinë. Operatori aplikues duhet të marrë parasysh dhe të sqarojë efektet e tarifave shtesë të propozuara të roaming dhe shpërndarjen e tyre te përdoruesit fundor. Propozimi për aplikim të tarifave shtesë që ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme ndërmjet shërbimeve/tarifave roaming (p.sh., tarifë shtesë shumë e lartë për një shërbim, dhe tarifë shumë e ulët ekstra për një shërbim tjetër) duhet të arsyetohen siç duhet nga operatori aplikues. Tarifat shtesë të qëndrueshmërisë (pas miratimit) mund të aplikohen që nga fillimi i përdorimit të shërbimeve celulare në roaming, duke filluar nga minuta, mesazhi SMS ose MB e parë e përdorur.

ANEKS 1

Skedari në format Excel i përfshirë si Aneks i këtyre Udhëzime të AKEP është sipas Aneks 1 të dokumentit të BEREC: *BoR (17) 56 BEREC Guidelines on Regulation (EU) No. 531/2012 as amended by Regulation (EU) No. 2015/2120 and Commission Implementing Regulation (EU) 2016/2286 (Retail roaming Guidelines).*

AKEP ka përshtatur skedarin e BEREC në kontekstin e roming-ut në Ballkanin Perëndimor sipas marrëveshjes RRA dhe vendimeve nr. 22-24/2019, dhe Rregullores së FUP të AKEP. Skedari përmban tabela dhe formula që mund të përdoren në kërkesën e operatorit celular për autorizim për zbatim tarife shtesë roaming-u në Ballkanin Perëndimor, për të siguruar qëndrueshmërinë e modelit të tarifimit në Shqipëri sipas përcaktimeve të Rregullores së FUP të AKEP. Me qëllim ruajtjen e funksionalitetit të tij, skedari në excel është lënë në gjuhën angleze.